



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E Mërkurë, 17 Dhjetor 2014

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 53, datë 1.12.2014	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të vendimit nr. 419, datë 2.10.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	10653
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 54, datë 5.12.2014	Me objekt: 1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet qeverisjes vendore, Bashkisë së Tiranës, dhe pushtetit qendror, Këshilli i Ministrave/Këshilli Kombëtar i Territorit. 2. Shqyrtimi i pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe me Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore, si dhe shfuqizimi si antikushtetues, si akt që bëhet shkak për lindjen e konfliktit, të vendimit nr. 5, datë 18.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike”. 3. Pezullimi i zbatimit të vendimit nr. 5, datë 18.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit deri në përfundimin e shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese.....	10659
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 55, datë 5.12.2014	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimeve nr. 240, datë 8.2.2012, të Gjykatës së Lartë; nr. 530, datë 20.12.2010, të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 2000, datë 30.7.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.....	10668
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 5.12.2014	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimeve nr. 3530, datë 29.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 113, datë 5.3.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 1640, datë 12.7.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	10673

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 57, datë 5.12.2014	<p>Me objekt: 1. Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 354, datë 4.6.2014 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e bazës së të dhënave IMEI për regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme”.</p> <p>2. Pezullimi i vendimit nr. 354, datë 4.6.2014 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e bazës së të dhënave IMEI për regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme”.....</p>	10677
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 58, datë 5.12.2014	<p>Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2011-863 (241), datë 12.5.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....</p>	10682



**VENDIM**  
**Nr. 53, datë 1.12.2014**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 17.9.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 31 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Ardian Barçi, Floresha Kokojka Barçi, Pëllumbesha Barçi, Edi Barçi, Skënder Drinziu, Irena Brovina Barçi, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokat Envi Hicka.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Ministria e Financave, në mungesë Bashkia Korçë

Uzina e Instrumentave Korçë, në mungesë Kozeta Simo, Mariela Simo, Emis Simo (trashëgimtarët e të ndjerit Foti Simo), përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokat Thimio Kondi.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i vendimit nr. 419, datë 2.10.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 41, 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 1 i protokollit nr. 1.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, që janë shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuar, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**  
**I**

1. Kërkuësit janë trashëgimtarë ligjorë të ish-pronarit S.B., të cilit i është njohur e drejta e pronësisë me vendimin nr. 505, datë 19.9.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Korçë. Sipas këtij vendimi, trashëgimtarëve u është njohur e drejta e kompensimit për 6000 m<sup>2</sup> dhe e drejta e parablerjes për objektet e ndërtuara nga shteti në sipërfaqen prej 5000 m<sup>2</sup>.

2. Në vitin 2007, Bashkia Korçë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Objekteve Publike pranë Ministrisë së Financave kanë shitur në favor të shtetasit F.S. objektin “repart vegla dore, lamini, tërheqje, derdhje precize” të Uzinës së Instrumenteve Korçë, me sipërfaqe të përgjithshme 1356 m<sup>2</sup> nga të cilat 1190 m<sup>2</sup> të ndodhura nën objekt.

3. Trashëgimtarët e S.B., duke pretenduar mosrespektimin e të drejtës së parablerjes së objektit të mësipërm i cili ndodhej në sipërfaqen që u ishte njohur me vendim të ish KKKP-së Korçë, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me kërkesëpadi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes nr. 7729 rep., 2250 kol., datë 15.11.2007.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 1149, datë 29. 4.2008, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pambështetur në ligj dhe në prova.

5. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 258, datë 4.9.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

6. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 419, datë 2.10.2012, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

**II**

7. **Kërkuësit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në Gjykatën e Lartë. Në mënyrë të përmbledhur argumentet e tyre janë si vijon:

7.1 Është cenuar e drejta e aksesit:

7.1.1 Përmbajtja e nenit 474 të Kodit të Procedurës Civile që kërkon nënshkrimin e rekursit nga palët, avokati apo një përfaqësues me prokurë, është interpretuar nga Kolegji Civil në mënyrë që cenon thelbin e së drejtës së aksesit në gjykatë.



7.1.2 Kolegji Civil përpara se të vendoste mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit duhet të verifikonte nëse sekretaria gjyqësore kishte përmbushur detyrimin ligjor për vënien në dijeni të palës që ka bërë rekursin, për ta plotësuar atë me nënshkrimin e tij ose të avokatit, në referim të nenit 476 të KPC-së.

7.1.3 Dispozitat procedurale evidentojnë qartë pamundësinë dhe pengesën ligjore të Gjykatës së Lartë për të refuzuar në seancë gjyqësore shqyrtimin në themel të pretendimeve, të kthejë, ose të vendosë mospranimin e ankimit, ose të pushojë gjykimin e çështjes nëse paraprakisht nuk janë realizuar veprimet e njoftimit të palës ankuese për të ndrequr dhe plotësuar të metat e ankimit të parashtruar prej saj, në referim të nenit 450 dhe 154/a të KPC-së.

7.1.4 Edhe referimi i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 36, datë 5.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese është i gabuar, pasi ky vendim i referohet rastit kur ankimi është nënshkruar nga një mbrojtës i paautorizuar rregullisht.

7.1.5 Ndryshe nga sa arsyeton Gjykata e Lartë në lidhje me “neglizhencën e theksuar” të palëve, synimi dhe vullneti i tyre për të ushtruar rekurs u provua nëpërmjet pjesëmarrjes në seancë gjyqësore të avokatit për mbrojtjen e interesave ligjore. Në këtë kuptim, Kolegji Civil ishte përpara detyrimit të shtyrjes së seancës gjyqësore për të realizuar përmes sekretarisë gjyqësore procedurat për ndreqjen dhe plotësimin e të metave të rekursit.

7.1.6 Kolegji Civil duhet të zbatonte nenin 474 të KPC-së në analogji me normat procedurale penale, praktikën e unifikuar dhe jurisprudencën kushtetuese në lidhje me rastet e mosnënshkrimit të rekursit nga mbrojtësi i të pandehurit si shkak për mospranimin e rekursit.

7.1.7 Mosveprimi i gjykatës për shkak të jurisprudencës mbi procesin civil cenon parimin e barazisë para ligjit, duke lejuar që individët të kenë status të diskriminuar në procesin civil në raport me atë penal.

7.2 Është cenuar *parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 485/e të KPC-së ka disponuar tej kompetencave ligjore. Kolegji Civil ka të drejtë të prishë vendimet dhe të pushojë gjykimin e çështjes, por në asnjë rast nuk mund të vendosë vetëm pushimin e çështjes.

Faqe | 10654

## 8. *Subjektet e interesuara, Kozeta Simo e të tjerë, kanë prapësuar në mënyrë të përmbledhur se:*

8.1 Kërkuesit kanë paraqitur në mënyrë të shtrembëruar faktet dhe rrethanat e çështjes, pasi procedura e parablerjes së pronës shtetërore ka filluar që në vitin 1998, pas plotësimit të dosjes së privatizimit dhe njoftimit katër herë në tri gazeta me qarkullim kombëtar si dhe duke vendosur afishe në vende publike. Kërkuesit nuk paraqitën dokumente për të përfituar nga e drejta e parablerjes.

8.2 Pretendimi i cenimit të së drejtës së aksesit nga Gjykata e Lartë është i pabazuar, pasi dispozita e KPC-së parashikon në mënyrë të qartë se rekursi duhet të nënshkruhet nga vetë pala, avokati apo përfaqësuesi me prokurë. Kërkuesit konfundojnë qëllimisht kuptimin e nenit 474 të KPC-së me atë të nenit 476, kjo për faktin se mungesa e kushteve të përcaktuara nga ky nen e bën rekursin të paplotë, por jo të pavlefshëm, prandaj ligjvënësi vetëm në këtë rast ka parashikuar detyrimin e administratës gjyqësore për t'i caktuar një afat 10-ditor për plotësimin e rekursit. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë ka bërë një interpretim dhe zbatim korrekt të nenit 474 të KPC-së.

8.3 Edhe referimi i kërkuesve në jurisprudencën kushtetuese është i pavend, pasi kërkuesi i referohet vendimeve ku e drejta e aksesit është vlerësuar e cenuar si rezultat i rekurseve të panënshkruara nga mbrojtësi që nuk ka pasur në mënyrë të shprehur tagrat e përfaqësimit, apo kur rekursi nuk përmbajnë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të gjykatës së apelit.

8.4 Për sa i përket cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, kërkuesit nuk kanë parashtruar argumente bindëse e të sakta. Kërkuesit i referohen një vendimi të GJEDNJ-së që nuk ka ngjashmëri me çështjen konkrete, kurse për sa i përket argumentit për tejkalim kompetencash nga Gjykata e Lartë, pretendimi është i pabazuar.

8.5 Po ashtu i pabazuar është edhe pretendimi mbi cenimin e të drejtës për t'u dëgjuar, pasi vlerësimi i plotësimit të kriterëve formale të rekursit është kompetencë e dhomës së këshillimit dhe jo i seancës gjyqësore. Kur ekziston shkak i mospranimin të rekursit pushimi i gjykimin mund të bëhet pa kufizim në çdo fazë të gjykimin.

9. *Subjekti i interesuar, Bashkia Korçë*, ka prapësuar me shkrim se kontrata e shitjes së



pasurisë së paluajtshme ka respektuar të gjitha procedurat ligjore që i paraprijnë lidhjes së saj, ashtu sikundër është provuar edhe gjatë gjykimit nga pala e paditur Ministria e Ekonomisë.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkesuesve

10. Kërkesuesit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës; *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10. 2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, si dhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e tyre *prima facie*, përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

##### B. Për themelin e çështjes

11. Gjykata, përpara se të shqyrtojë bazueshmërinë e pretendimeve të kërkesit thekson, paraprakisht, se ajo i vlerëson këto pretendime në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që duhet të përmbushin gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në respekt të së drejtës së mbrojtjes.

12. Jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 35, datë 20.12.2005, nr. 14, datë 17.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19 datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 52, datë 2.12.2013, nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006, nr. 19 datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

##### C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë

13. Kërkesit kanë pretenduar se vendimi i Kolegjit Civil për pushimin e gjykimit të çështjes si rezultat i depozitimit të rekursit të panënshkruar nga vetë palët dhe as nga mbrojtësit e tyre me prokurë të posaçme u ka cenuar të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë.

14. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj të vazhdueshme e ka vlerësuar të drejtën e ankimit, të parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës, si mundësi të çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individit) të drejtën për t’u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimet nr. 5, datë 2.3.2010; nr. 12, datë 14.4.2010; nr. 14, datë 26.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Sipas jurisprudencës kushtetuese, në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit, ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile/penale, është pjesë e të drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 4, datë 23.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).



16. Për sa i përket rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 480 i KPC-së parashikon se Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është organi që analizon dhe vlerëson nëse shkaqet e ngritura në recurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraeliminatory të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sigurisht që palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh, *prima facie* i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë publike, por kjo nuk mund t'ia deformojë funksionin vlerësues dhomës së këshillimit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në recurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimin nr. 22, datë 6.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, konstaton se kërkuessit kanë depozituar recurs brenda afatit ligjor. Kopja e rekursit të administruar në dosjen gjyqësore përmban emrin dhe vulën e avokatit, ndërkohë që i mungon firma e tij dhe ajo e palëve. Gjithashtu, në dosje gjenden të administruara edhe njoftimet e palëve për zhvillimin e seancës gjyqësore të datës 2.10.2012, të nënshkruara nga Kancelari i Gjykatës së Lartë. Në datën 25.6.2010, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, pasi ka dëgjuar relacionin përkatës dhe ka diskutuar çështjen në tërësi, ka vendosur se rekursi i paraqitur përmban shkaqe nga ato parashikuara nga neni 472 i KPC-së dhe për rrjedhojë, bazuar edhe në nenin 480 të KPC-së, ka vendosur kalimin për gjykim të çështjes civile.

18. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 6.9.2012 rezulton se kërkuessit janë përfaqësuar nga dy mbrojtës të pajisur me prokurë të posaçme. Kolegji Civil ka pranuar me vendim të ndërmjetëm kërkesën paraprake të

paraqitur nga njëri mbrojtës i kërkuessve për kalim procedural të dy palëve paditëse. Më pas, procesi gjyqësor ka vijuar me administrimin e vendimeve gjyqësore për lëshimin e dëshmimeve të trashëgimisë ligjore, kalimin procedural të palëve dhe, në fund, Kolegji Civil ka vendosur shtyrjen e seancës me shpallje. Në seancën gjyqësore të datës 2.10.2012 përfaqësuesi i Avokaturës së Shtetit ka ngritur pretendimin mbi mungesën e nënshkrimeve në rekursin e depozituar në dosjen gjyqësore. Në lidhje me këtë pretendim mbrojtësi i kërkuessve, ka prapësuar se ka qenë një gabim material që nuk mund të përbente shkak për pushimin e gjykimit. Në përfundim të procesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

19. Kodi i Procedurës Civile, në nenin 474, përcakton se rekursi që i drejtohet Gjykatës së Lartë nënshkruhet nga vetë pala, avokati apo përfaqësuesi i tij i pajisur me prokurë. Krahas kërkesës për nënshkrim, KPC-ja në nenin 475 përcakton rregullat në lidhje me përmbajtjen e rekursit, i cili duhet të evidentojë domosdoshmërisht palët ndërgjyqëse, vendimin që kundërshtohet, paraqitjen e përmbledhur të fakteve të çështjes, shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet dhe prokurën nëse rekursi është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesit.

20. Gjithashtu, dispozitat procedurale parashikojnë rregulla konkrete edhe në lidhje me depozitim të rekursit. Konkretisht, në referim të nenit 476, rekursi depozitohet bashkë me kopje të vërtetuar të vendimit të kundërshtuar dhe, kur është rasti, edhe të njoftimit kur ky është bërë. Po ashtu, duhet depozituar edhe prokura e posaçme dhe aktet e dokumentet mbi të cilat është bazuar rekursi në aq kopje sa janë palët. Dispozita në fjalë përcakton shprehimisht rregullin se kur nuk plotësohen kushtet e mësipërme, palës i njoftohet një afat 10 ditor për të bërë plotësimet dhe nëse pas këtij afati nuk bëhen plotësimet, rekursi kthehet.

21. Gjykata vlerëson se rekursi është akti procedural në të cilin parashtrihen shkaqet e kundërshtimit të një vendimi sipas kërkesave të nenit 472 të KPC-së, dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin rekursuesit i jepet mundësia për të pasur akses në Gjykatën e Lartë. Për shkak



të rëndësisë që paraqet ky akt procedural në drejtëm të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore, Gjykata vlerëson se kërkesa e nenit 474 të KPC-së për nënshkrimin e rekursit civil duhet të vlerësohet në harmoni me tërësinë e elementeve të tjera që duhet të verifikohen paraprakisht me qëllim sigurimin e efektivitetit të mjetit procedural të ushtruar nga palët. Në këtë kuptim, zbatimi i nenit 474 të KPC-së duhet parë në raport edhe me rregullimet e përgjithshme që disjunojnë paraqitjen e ankimit si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit.

22. Gjykata rithekson se personi që ushtron ankim/rekurs është i interesuar të ndjekë fatin e ankimit të tij, por kjo nuk nënkupton se i takon vetëm atij përgjegjësia të ndjekë pafundësisht fatin e dosjes gjyqësore, e cila administrohet nga gjykata dhe jo nga kërkuesi (*shih vendimet nr. 38, datë 30.12.2010 dhe nr. 32, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë arsye, Gjykata çmon se i takonte administratës gjyqësore të Gjykatës së Lartë ose të Gjykatës së Apelit Korçë të njoftonte në kohë kërkuesit për plotësimin e nënshkrimeve të munguara në recurs duke qenë se ajo administronte dhe dosjen gjyqësore. Gjithashtu, nuk provohet me asnjë shkresë ose dokument tjetër që kërkuesit të jenë njoftuar nga administrata gjyqësore për mungesat në paraqitjen e rekursit, ndonëse në bazë të nenit 476/2 të KPC-së, ka detyrimin të verë në dijeni rekursuesin për mangësitë formale të rekursit.

23. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa e nenit 474 të KPC-së për nënshkrimin e rekursit nga vetë pala, avokati ose përfaqësuesi me prokurë është një element që përfshihet në kushtet që duhet të verifikojë sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin e kundërshtuar, përpara se ajo të përcjellë zyrtarisht në sekretarinë e Gjykatës së Lartë dosjen përkatëse së bashku me dokumentet e tjera. Madje edhe sekretaria e Gjykatës së Lartë nuk shkarkohet nga detyrimi dhe përgjegjësia për të verifikuar çdo element që duhet të plotësojë rekursi me qëllim që të garantohet e drejta e aksesit të individit në Gjykatën e Lartë. Një interpretim i ndryshëm, që mund t'i bëhet përmbajtjes së rregullave procedurale mbi kushtet dhe kriteret e paraqitjes së rekursit, nuk i shërben rritjes së standardit në favor të garancive për të mos humbur të drejtën e gjykimit,

përkundrazi sjell si pasojë cenimin e të drejtës së rekursuesit për akses në Gjykatën e Lartë.

24. Gjykata, duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës së Kasacionit të Italisë, nisur nga ngjashmëritë midis nenit 474 të KPC-së me nenin 125 të KPC Italian, konstaton se dispozita procedurale është interpretuar në mënyrë të gjerë. Konkretisht për rastin e mungesës së nënshkrimit dhe pavlefshmërinë që mund të shkaktojë kjo mangësi, Gjykata e Kasacionit është shprehur se tashmë përbën *jus receptum* fakti që kur elementi formal, të cilit rendi juridik i përcakton funksionin e lidhjes që duhet të ekzistojë ndërmjet tekstit të aktit dhe autorit të tij, del qartë nga elementë të tjerë të vetë aktit, apo kryhen veprime të tjera procedurale (regjistrimi i çështjes, kërkohet të njoftohet akti, pjesëmarrja në seanca në prani të palës tjetër, etj.) nuk gjendemi në një rast pavlefshmërie të aktit (*shih vendimin nr. 9490/2007 të Gjykatës së Kasacionit Italian*).

25. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata thekson se, përderisa çështja civile ishte kaluar për shqyrtim në seancë dhe për sa kohë mbrojtësit ligjorë të rekursuesve ishin të pranishëm dhe të pajisur me tagra përfaqësimi në përpunje me formën e përcaktuar nga ligji, çka jo vetëm nuk tregonte neglizhencë të theksuar nga ana e tyre, por përkundrazi vullnetin për të vijuar procesin gjyqësor, Kolegji Civil kishte detyrimin t'i jepte mundësinë kërkuesve të shpreheshin mbi shkaqet e rekursit, për të vendosur më pas për pranimin ose jo të tij.

26. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se në momentin që çështja kalon për gjykim, prezumohet se kërkuesit i është njohur e drejta për t'u dëgjuar në një seancë publike nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ. Kolegji Civil, bazuar në nenin 485 të KPC, ka kompetencë të lerë në fuqi vendimin e kundërshtuar, ta prishë atë dhe ta rikthejë për gjykim në gjykatën përkatëse. Mungesa e shkaqeve të rekursit është shkak për mospranimin e tij që vendoset në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve (neni 480 i KPC-së). Po kështu, duke iu referuar nenit 483 të KPC rezulton se: "*në seancën gjyqësore relatori paraqet faktet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit, përmbajtjen e vendimit të ankimit dhe shkaqet e*



*rekursit dhe të kundërrkursit. Pas relativitetit kryetari fton avokatët të paraqesin mbrojtjen e tyre*”. Pra, dispozita e lidh zhvillimin e seancës gjyqësore me faktin që palët duhet të dëgjohen për pretendimet dhe bazueshmërinë e tyre në ligj dhe prova.

27. Në vështrim të standardeve dhe rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se ndonëse Kolegji Civil kishte detyrimin të dëgjonte palët në seancën e zhvilluar për këtë qëllim, në gjykimin konkret kjo rezultoi të mos jetë respektuar, duke passjellë një proces të parregullt në kuptimin kushtetues.

28. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuësve për cenimin e të drejtës për akses në Gjykatën e Lartë është i bazuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “P”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 419, datë 2.10.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj  
Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj

#### MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka vendosur pranimin e kërkesës së Ardian Barçit, etj. dhe për pasojë ka shfuqizuar vendimin nr. 419, datë 2.10.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Shumica ka arsyetuar se ky vendim u ka cenuar kërkuësve të drejtën për akses në Gjykatën e Lartë (*shih paragrafin nr. 28 të vendimit*). Nga

rrethanat e çështjes, nisur edhe nga pretendimet e kërkuësve, jam i mendimit se shumica duhet të konsideronte nëse, veç sa më sipër, vendimi i Gjykatës së Lartë së lartpërmendur ka cenuar edhe parimin e gjykatës së caktuar me ligj. Në këtë drejtim, kërkuësit kanë pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 485/e të KPC-së, ka disponuar tej kompetencave ligjore, duke marrë atributet e Kolegjit në dhomë këshillimi (shih nenet 480, në lidhje me nenet 472 dhe 474 të KPC-së).

2. Në çështjen në shqyrtim, sikurse thekson edhe shumica, rezultoi se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, pasi ka dëgjuar relacionin përkatës dhe ka diskutuar çështjen në tërësi, ka vendosur se rekursi i paraqitur nga kërkuësit, në të cilin gjendet emri dhe vula e avokatit, ndërkohë që mungon firma e tij dhe ajo e palëve, përmban shkaqe nga ato parashikuara nga neni 472 i KPC-së dhe për rrjedhojë, bazuar në nenin 480 të KPC-së, ka vendosur kalimin për gjykim të çështjes civile (*shih paragrafin nr. 17 të vendimit*). Vetëm pas disa seancash të zhvilluara, ku kanë marrë pjesë edhe mbrojtësit e kërkuësve, pas pretendimit të ngritur nga përfaqësuesi i Avokaturës së Shtetit për mungesën e nënshkrimeve në rekursin e depozituar në dosjen gjyqësore, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pushimin e gjykimin të çështjes për këtë shkak (*shih paragrafin nr. 18 të vendimit*).

3. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit





(shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese).

4. Në të drejtën procedurale civile kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 e vijues të KPC-së. Kështu, sipas nenit 480 të KPC-së, sikurse pranon edhe shumica, Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është organi që analizon dhe vlerëson nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, si dhe nëse plotësohen kërkesat procedurale të parashikuara në ligj, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraprak të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin nr. 16 të vendimit*). Ndër kërkesat e parashikuara në ligj është edhe parashikimi i nenit 474 të KPC-së. Pra verifikimi i nënshkrimit apo jo të rekursit është atribut i Kolegjit Civil në dhomë këshillimi.

5. Pas kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është i detyruar të respektojë kompetencat e tij, të cilat janë të përcaktuara në mënyrë taksative në nenin 485 të KPC-së. Në këto kushte, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mund të vendosë pushimin e gjykimit të çështjes vetëm në rastet e përcaktuara në nenin 485/e të KPC-së, pra vetëm kur arrin në përfundimin se duhen prishur vendimet e dy shkallëve të tjera.

6. Në këto rrethana, pushimi i gjykimit të çështjes, me arsyetimin se mungon nënshkrimi i rekursit, tejkalon kompetencat e Kolegjit Civil si më sipër. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në asnjë rast nuk mund të marrë atributet e Kolegjit Civil në dhomë këshillimi, për më tepër kur ky i fundit ka bërë një vlerësim të çështjes brenda kompetencave të tij.

7. Si përfundim, vlerësoj se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar tej kompetencave të njohura nga ligji procedural civil (neni 485/e i lartpërmendur), pasi ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për një shkak, mungesa e nënshkrimit në rekurs, i cili i përket vlerësimit të Kolegjit Civil në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë,

çmoj se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar jo vetëm të drejtën e aksesit në gjykatë të kërkuesve, por edhe parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

Anëtar: Vladimir Kristo

**VENDIM**  
**Nr. 54, datë 5.12.2014**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datat 11.6.2014 dhe 1.7.2014, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 26 Akti, që i përket:

KËRKUES: Bashkia e Tiranës

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Territorit

OBJEKTI: 1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet qeverisjes vendore, Bashkisë së Tiranës, dhe pushtetit qendror, Këshilli i Ministrave/Këshilli Kombëtar i Territorit.

2. Shqyrtimi i pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe me Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore, si dhe shfuqizimi si antikushtetues, si akt që bëhet shkak për lindjen e konfliktit, i vendimit nr. 5, datë 18.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike”.

3. Pezullimi i zbatimit të vendimit nr. 5, datë 18.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit deri në përfundimin e shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 124/1, 131/ç dhe 134/1/e të Kushtetutës së Republikës së



Shqipërisë dhe nenet 54, 55 dhe 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

1. Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), në mbështetje të neneve 6, 8 dhe 32 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” (*ligji nr. 10119/2009*), ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 3.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), ka miratuar vendimin nr. 5, datë 18.10.2013 “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike” (vendimi nr. 5/2013), me të cilin është vendosur përcaktimi i zonave ku do të ndërhyhet me masa të natyrës emergjente, sipas listës së inventarit të Ministrisë së Kulturës dhe hartave ilustruese (pika 1). Në pikën 2 të tij, akti parashikon pezullimin e dhënies së të gjitha llojeve të lejes zhvillimore në këto zona, nga autoritetet e planifikimit, deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, kurse në pikën 3 parashikohen rastet përjashtimore të dhënies së këtyre lejeve. Vendimi ka përcaktuar institucionet që ngarkohen për marrjen e masave emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në këto zona (pika 5), kurse për ndjekjen dhe zbatimin e pikave 2 dhe 3 të tij, vendimi ka ngarkuar autoritetet e planifikimit (pika 6).

#### II

#### Parashtrimet e palëve

2. **Bashkia e Tiranës (kërkuesi)**, e përfaqësuar nga kryetari i saj, pretendon se me miratimin e vendimit nr. 5/2013 ka lindur një konflikt kompetencash midis saj, si organ i pushtetit vendor, dhe KKT-së, si organ i qeverisjes qendrore dhe, për pasojë, i kërkon

Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) zgjidhjen e këtij konflikti dhe shfuqizimin e aktit që është bërë shkak për lindjen e tij. Si argumente për të mbështetur pretendimet e saj, Bashkia e Tiranës parashtron, në mënyrë të përmbledhur:

2.1 Pavarësisht titullit të tij, vendimi nr. 5/2013, mbështetur në bazën ligjore dhe përmbajtjen e tij, është një vendim për shpalljen e zonave të rëndësishme kombëtare lidhur me trashëgiminë kulturore. Neni 32 i ligjit nr. 10119/2009 përcakton procedurën për këtë lloj vendimmarrje. Bashkia e Tiranës, si palë e interesuar, përderisa në territorin e saj administrativ ka objekte të trashëgimisë kulturore, të cilat janë marrë në konsideratë edhe në planin e përgjithshëm të qytetit, nuk ka pasur asnjë njoftim për nisjen e një procedure të tillë. Po ashtu, në vendim nuk është përcaktuar objekti dhe/ose zona konkrete, si dhe kufijtë apo vendi në territor i tyre. Edhe pse vendimi i referohet listës së inventarit të Ministrisë së Kulturës, ajo nuk gjendet bashkëlidhur dhe nuk i është përcjellë zyrtarisht Bashkisë së Tiranës.

2.2 KKT-ja ka vendosur apriori dhe në mënyrë abuzive pezullimin e dhënies së lejeve të reja zhvillimore nga të gjitha autoritetet e qeverisjes vendore të planifikimit, edhe pse nuk jemi në kushtet e parashikuara nga neni 32 i ligjit nr. 10119/2009, pasi pezullimi nuk është vendosur gjatë nismës për përcaktimin e rëndësishme kombëtare të çështjes dhe deri në miratimin e saj.

2.3 Vendimi nr. 5/2013 është marrë në kundërshtim me nenin 64 të ligjit nr. 10119/2009, pasi afati i pezullimit i vendosur prej tij është i papërcaktuar, ndërkohë që ligji ka parashikuar një afat maksimal pezullimi 12 muaj.

2.4 Vendimi nr. 5/2013 cenon parimin e decentralizimit të pushtetit vendor, duke i atribuar pushtetit qendror çështje të administrimit të territorit dhe dhënies së lejeve të ndërtimit dhe duke bllokuar vendimmarrjen lokale dhe veprimtarinë e njësisve të qeverisjes vendore në fushën e planifikimit, menaxhimit urban dhe të kontrollit të territorit. Pezullimi i dhënies së lejeve të ndërtimit cenon drejtpërdrejt veprimtarinë e organeve të planifikimit urban dhe ndërhyrja e KKT-së nuk është e justifikueshme.

2.5 Vendimi nr. 5/2013 cenon parimin e autonomisë vendore dhe të proporcionalitetit të ndërhyrjes së pushtetit qendror, duke shkelur



edhe standardet e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Organet e qeverisjes vendore, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (ligji nr. 8652/2000), kanë hartuar planet e përgjithshme vendore ose planet e detajuara vendore. Vendimmarrja e KKT-së për të pezulluar zhvillimin e zonave nuk i krijon mundësi autoritetit vendor të gëzojë instrumentet e nevojshme ligjore për ushtrimin normalisht të funksionit dhe të vendimmarrjes në fushën e planifikimit urban, duke e vendosur atë, në këtë mënyrë, nën vullnetin e pushtetit qendror.

2.6 Pezullimi nuk është përdorur në proporcion me rrethanat që e diktojnë atë dhe kur rezulton se instrumente të tjera në fuqi nuk do jepnin zgjidhje të përshtatshme.

2.7 Edhe pse pezullimi i njihet si kompetencë AKPT-së, në rastin konkret ai është vendosur nga KKT-ja.

2.8 Në pikën 5 të tij, vendimi nr. 5/2013 ngarkon organet e pushtetit qendror për të ndërmarë masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese të këtyre zonave, përcaktim ky që bie ndesh me parimin e autonomisë vendore dhe proporcionalitetit, pasi funksioni parësor i pushtetit vendor është administrimi i territorit nën juridiksionin e tyre, që përfshin edhe masat për mbrojtjen apo rehabilitimin e tij.

3. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave,** ka prapësuar para Gjykatës sa vijon:

3.1 Kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë ekzistencën e interesit të drejtpërdrejtë, vetjak dhe të ligjshëm, çka është kusht për legjitimitimin e tij.

3.2 Vendimi nr. 5/2013 i KKT-së është një akt me karakter individual dhe jo normativ, pasi ai përmban rregulla konkrete që përcaktojnë vetëm zonat ku do të ndërmerren masa me natyrë emergjente dhe nuk vendos rregulla me karakter të përgjithshëm dhe abstrakt. Si i tillë, ai nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues, në kuptim të nenit 131/c të Kushtetutës.

3.3 Në rastin konkret nuk jemi në asnjë nga përcaktimet që i ka bërë jurisprudenca kushtetuese mosmarrëveshjes së kompetencave. Përdorimi i formës së konfliktit “normativ” do të kërkonte që si kërkim fillestar të vinte pajtueshmëria me Kushtetutën e ligjit ku është bazuar subjekti i

interesuar për nxjerrjen e aktit. Kërkuesi nuk ka zgjedhur formën e duhur të mosmarrëveshjes për të realizuar kërkimin e saj, pasi në rastin konkret objekt është shfuqizimi i një akti të KKT-së dhe jo i një ligji apo dispozitive të caktuara të tij. Akti i kundërshtuar nuk është shkak i mosmarrëveshjes së pretenduar nga kërkuesi, pasi ai nuk i merr kërkuesit asnjë nga kompetencat që Kushtetuta parashikon në nenin 108 të saj.

3.4 Vendimi nr. 5/2013 nuk është një vendim për shpalljen e zonave të rëndësisë kombëtare lidhur me trashëgiminë kulturore, por në tërësinë e tij ai vetëm rregullon marrëdhëniet e të gjitha subjekteve të interesuara në zona të rëndësisë kombëtare, sipas listës së inventarit ekzistues të Ministrisë së Kulturës. Kërkuesi nuk ka evidentuar ndonjë ndryshim apo shtesë në listën ekzistuese të këtij inventari. Në këto kushte kërkesa nuk përcakton thelbin e konfliktit. Për sa kohë nuk ka përcaktim të zonave të reja, kjo do të thotë se nuk ka nisur asnjë proces për përcaktimin e tyre që do të kërkonte edhe përmbushjen etributeve të kërkuesit për të qenë pjesë e tërësisë së vendimmarrjes në këtë proces.

3.5 Vendimi nr. 5/2013 motivohet nga gjendja e emergjencës në territor dhe objekt i tij janë zonat me rëndësi kombëtare, për të cilat ka akte të miratuara nga organet përkatëse qendrore. Pezullimi i përkohshëm i zhvillimit, si instrument tipik dhe urgjent në dispozicion të autoritetit të planifikimit, është vlerësuar të jetë i vetmi instrument që, në kushtet aktuale, garanton realizimin e interesit publik në mbrojtjen dhe rehabilitimin mjedisor të zonave me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike.

3.6 Kërkuesi nuk mohon kompetencën e pushtetit qendror për vendimmarrjen objekt gjykimi, por pretendon se këtë kompetencë e ka AKPT-ja dhe jo KKT-ja, pra, sipas tij, kemi të bëjmë me një konflikt civil/administrativ për tejkalim të kompetencave të KKT-së dhe jo me një konflikt kushtetues kompetencash.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 5/2013

4. Kërkuesi ka kërkuar pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 5/2013 të KKT-së deri në dhënien e vendimit përfundimtar të Gjykatës, me



pretendimin se në rastin konkret, pezullimi i dhënies së lejeve të zhvillimit dhe i planeve vendore cenon si interesat e bashkive e komunave, ashtu edhe të individëve. Ai pretendon se vendimi nr. 5/2013, nga njëra anë i vendos organet e qeverisjes vendore në pamundësi për të përmbushur funksionet e tyre në shërbim të qytetarëve dhe ato nuk arrijnë dot të mbledhin të ardhurat që vijnë nga procesi i zhvillimit të zonave dhe, nga ana tjetër, cenon të drejtat e pronarëve të ligjshëm për të zhvilluar pronat e tyre në përputhje me planet vendore të zhvillimit. Sipas kërkesit, dëmi i shkaktuar nga zbatimi i këtij akti është i rëndë dhe pothuajse i pamundur për t'u riparuar.

5. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, përpara zhvillimit të seancës plenare, mori në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 5/2013. Në kuptim të nenit 45, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 8577/2000), subjekti që kërkon pezullimin e një akti duhet të provojë preken e interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si dhe pasojat e pariparueshme që do të sillte zbatimi i aktit. Në kuptim të sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e cenimit të interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtij vendimi dhe për këtë arsye, në mbledhjen e datës 7.5.2014, vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim.

*B. Për pretendimin për legjitimitetin e Bashkisë së Tiranës*

6. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në prapësimet e tij ka pretenduar se kërkuesi nuk legjitimohet për iniciimin e këtij gjykimi kushtetues, për arsye se ai nuk është as subjekt në konflikt dhe as subjekt i prekur drejtpërdrejt nga konflikti.

7. Bazuar në nenin 131, shkronja “ç”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor) si dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror - qeverisje vendore). Kjo dispozitë kushtetuese është detajuar në nenin 54 të ligjit nr. 8577/2000, i cili parashikon se kërkesa

ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti (pika 3) dhe se bazë për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve përbën çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve ose i organeve të qeverisjes vendore që ka çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre (pika 4). Pavarësisht nga karakteri i shkakut që lind mosmarrëveshjen, Gjykata vendos, sipas nenit 56 të po këtij ligji, se cili organ i pushtetit ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Veç kësaj, kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ka të bëjë me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata shqyrton edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit (*shih vendimin nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në mënyrë që të arrihet në një përfundim lidhur me ekzistencën ose jo të mosmarrëveshjes së pretenduar, Gjykata duhet të analizojë se midis cilave organe ekziston konflikti, cila është kompetenca që ushtrohet nga organi tjetër dhe në ç'mënyrë pengohet ushtrimi i saj ose në ç'mënyrë një organ e ushtron pa të drejtë një kompetencë të një organi tjetër. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se KKT-ja është një organ që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe Kryetar i saj është Kryeministri (neni 8 i ligjit nr. 10119/2009). Pra, vendimi i kundërshtuar i KKT-së është një akt i qeverisjes qendrore. Bashkia e Tiranës, e cila në kuptim të ligjit nr. 8652/2000 është njësi bazë e qeverisjes vendore, pretendon se pezullimi i dhënies së lejeve zhvillimore në zonat e përcaktuara, pa asnjë afat dhe pa asnjë kriter, përbën cenim të kompetencave të këtij organi të qeverisjes vendore, në kundërshtim me parimet e decentralizimit të pushtetit, të autonomisë vendore, të subsidiarititetit dhe të proporcionalitetit, të parashikuara në nenin 13 të Kushtetutës dhe në Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, formalisht, janë të pranishme elementet e një mosmarrëveshjeje kompetencash. Kërkesa është ngritur nga një organ i qeverisjes vendore, i cili pretendon se një organ i qeverisjes qendrore ka ndërhyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e tij si



autoritet vendor i planifikimit, duke e penguar në përdorimin e instrumenteve ligjore për ushtrimin normalisht të funksionit, çka ka çuar në mosushtrimin e kompetencës në fushën e planifikimit, të menaxhimit urban dhe të kontrollit mbi territorin, të cilat bëjnë pjesë në funksionet e veta të saj, të njohura nga Kushtetuta. Për pasojë, organi i qeverisjes vendore ka kërkuar edhe shfuqizimin e aktit që është bërë shkak për lindjen e kësaj mosmarrëveshjeje.

9. Gjykata vëren, gjithashtu, se vendimi nr. 5/2013 i shtrin efektet e tij në të gjitha zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike, pra në të gjithë territorin e vendit dhe nuk iu referohet specifikisht zonave të ndodhura në një njësi të caktuar të qeverisjes vendore. Bazuar në parashtrimet e kërkuarit dhe subjektit të interesuar, rezulton se Bashkia e Tiranës ka në territorin e saj administrativ objekte të trashëgimisë kulturore, të cilat, sipas kërkuarit, janë marrë në konsideratë dhe vlerësuar edhe në miratimin e planit të përgjithshëm vendor të qytetit të Tiranës. Për pasojë, Gjykata vlerëson se vendimi nr. 5/2013 i shtrin efektet e tij edhe mbi territorin e Bashkisë së Tiranës.

10. Për sa i përket legjitimitimit formal dhe procedural, është pikërisht kryetari i bashkisë, si organ i qeverisjes vendore, që justifikon interesin e tij për të vënë në lëvizje Gjykatën në këtë rast. Bazuar në ligjin nr. 8652/2000 kryetari i bashkisë ushtron të gjitha kompetencat që ligji i ka njohur bashkisë në fushën e planifikimit urban, kurse bazuar në nenin 70/10 të ligjit nr. 10119/2009, kryetari i bashkisë është autoriteti përgjegjës për pranimin, shqyrtimin dhe vendimmarrjen për kërkesa për leje zhvillimore, për leje objekti, leje infrastrukture apo leje të veçantë, brenda territorit në juridiksion të bashkisë. Për sa më sipër, kërkuari legjitimohet edhe *ratione personae* në paraqitjen e kësaj kërkesë.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave paraqitet brenda 6 muajve nga data e lindjes së konfliktit. Gjykata vëren se vendimi nr. 5/2013 i cili, sipas kërkuarit, është bërë shkak për lindjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, është miratuar nga KKT-ja në datën 18.10.2013, kurse kërkesa

në Gjykatë është paraqitur në datën 15.4.2014, pra brenda afatit ligjor 6 mujor.

C. Për pretendimin për mungesën e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese

12. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka ngritur edhe pretendimin për mungesën e juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e vendimit të KKT-së, për shkak të karakterit të tij individual dhe jo normativ. Sipas këtij subjekti, kërkuari nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi vendimi nr. 5/2013 është një akt me karakter individual dhe, si i tillë, nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues, sipas nenit 131/c të Kushtetutës.

13. Gjykata vëren se në shkronjën “c”, të nenit 131 të Kushtetutës është përcaktuar kompetenca e saj për të shqyrtuar pajtueshmërinë me Kushtetutën edhe të akteve normative të organeve qendrore dhe vendore. Në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme, prandaj, gjatë ushtrimit të kontrollit abstrakt të normës, Gjykata ndalet, paraprakisht, në natyrën e aktit të kundërshtuar, çka lidhet drejtpërdrejt me juridiksionin e saj mbi shqyrtimin substancial të aktit normativ.

14. Kompetenca e Gjykatës për të vendosur për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve është parashikuar në shkronjën “ç” të nenit 131 të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet në formën e konfliktit “*normativ*”, kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu si edhe në formën e konfliktit “*individual*”, kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse për zbatimin e një ligji konkret, akt i cili bëhet shkak për mosmarrëveshjen. Mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen edhe kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy ose më shumë institucioneve, apo kur ligje të ndryshme u atribuojnë të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, si dhe kur ligji parashikon kompetencën, por pa saktësuar organin që duhet



ta ushtrojë atë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto*. Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe ka nxjerrë, mbi këtë bazë, aktin individual të zbatimit (*shih vendimet nr. 26, datë 4.12.2006; nr. 29, datë 21.12.2006; nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në praktikë, një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit, me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit (*shih vendimin nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë mënyrë, vlerësimi i Gjykatës përqendrohet mbi mosmarrëveshjen në lidhje me kryerjen e funksioneve të nivelit kushtetues, për të cilin akti është thjesht (edhe pse i nevojshëm) një tregues. Gjykata zgjidh konfliktin që i nënshtrohet gjykimit të saj duke deklaruar pushtetin të cilit i takojnë kompetencat në diskutim, çka është edhe qëllimi i këtij lloj kontrolli dhe, kur është nxjerrë një akt i vesuar nga moskompetenca, e shfuqizon atë. Në çështje të tilla, ushtrimi i kësaj kompetence të Gjykatës nuk kufizohet nga natyra e aktit që është bërë shkak për lindjen e konfliktit, prandaj ai mund të jetë një akt çfarëdo me karakter ligjor e nënligjor ose edhe një akt formalisht dhe materialisht administrativ.

16. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i subjektit të interesuar për mungesën e juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e kësaj çështjeje është haptazi i pabazuar.

#### *D. Për thelbin e pretendimeve*

17. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit janë përqendruar në dy argumente kryesore. Së pari, kërkuari pretendon se pavarësisht nga titulli i tij, vendimi nr. 5/2013 është një vendim për shpalljen e zonave të rëndësishme kombëtare lidhur me trashëgiminë kulturore dhe se nuk është respektuar procedura e parashikuar nga ligji nr. 10119/2009 për këtë lloj vendimmarrjeje, pasi në raste të tilla ligji parashikon, nga ana e organeve përgjegjëse, edhe organizimin e një procesi dëgjimi publik për të marrë vërejtjet apo propozimet e palëve të interesuara. Sipas kërkuarit, edhe pse Bashkia e Tiranës ka në territorin e saj objekte të trashëgimisë kulturore, nuk ka pasur asnjë njoftim për nisjen e një

procedure të tillë. Së dyti, kërkuari pretendon se KKT-ja, pa mbajtur në konsideratë kushtet e përcaktuara nga ligji, si dhe kompetencat e organeve të qeverisjes vendore, ka vendosur, në mënyrë abuzive, pezullimin e dhënies së lejeve të reja zhvillimore nga të gjitha autoritetet e qeverisjes vendore të planifikimit. Sipas tij, i vetmi rast kur autoriteti i planifikimit në nivel kombëtar vendos pezullimin është ai i parashikuar në nenin 32 të ligjit, por, në këtë rast, nuk janë respektuar kushtet ligjore, pasi: pezullimi nuk është vendosur gjatë nismës për përcaktimin e rëndësisë kombëtare të çështjes; pezullimi i njihet si kompetencë AKPT-së dhe jo KKT-së dhe pezullimi i zhvillimit nuk është përdorur në proporcion me rrethanat që e diktojnë atë.

18. Gjykata rithekson se një mosmarrëveshje kompetencash ndërmjet pushteteve mund të lindë kur një akt ose një sjellje, që konsiderohet e paligjshme, i sjell kërkuarit një dëm, sepse ndërhyr në sferën e kompetencave tërësisht ose pjesërisht të njohura atij. Pra, që të lindë një konflikt i tillë duhet të ketë një shkelje të sferës së kompetencave. Konflikti gjykohet i pranueshëm edhe kur, dhe pse nuk është kundërshtuar përkatësia e pushtetit, “përdorimi i keq” që i është bërë atij pasqyron një zvogëlim të kompetencave të garantuara kushtetutshmërisht subjektit kërkuar. Në një rast të tillë organi i cenuar nuk kërkon për vete kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon se një akt i një organi tjetër ose sjellja mosvepruese e tij i kanë zvogëluar kompetencat apo e kanë penguar në ushtrimin e tyre.

19. Në rastin konkret, kërkuari pretendon lindjen e konfliktit për shkak se organi i qeverisjes qendrore, me anë të aktit që ka miratuar, ka ndërhyrë drejtpërdrejt në veprimtarinë e organeve të planifikimit urban, duke bllokuar vendimmarrjen lokale dhe veprimtarinë e njësive të qeverisjes vendore në fushën e planifikimit, menaxhimit urban dhe të kontrollit të territorit.

20. Gjykata ka theksuar se thelbi i nenit 13 të Kushtetutës janë parimet e decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore. Qeverisja vendore nënkupton të drejtën e njerëzve në bashkësinë e caktuar territoriale që në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre nëpërmjet



organeve të cilat i zgjedhin vetë ose në mënyrë të drejtpërdrejtë. Parimi i decentralizmit të pushtetit është parim thelbësor mbi të cilin ngrihet dhe funksionon qeverisja vendore. Ai ushtrohet nëpërmjet parimit kushtetues të autonomisë vendore dhe kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetëqeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të qeverisjes vendore si dhe raporti që ajo ka me pushtetin qendror varen nga kuptimi kushtetues dhe ligjor që u jepet decentralizmit të pushtetit, autonomisë vendore dhe vetëqeverisjes (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Decentralizmi është një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohet nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore. Në themel të decentralizmit qëndron parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit “ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t’u takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve.” Kurse autonomia është një regjim i tillë juridik, në të cilin organet e njësisë vendore veprojnë në pavarësi për zgjidhjen e atyre çështjeve që Kushtetuta dhe ligjet ua kanë lënë atyre në kompetencë. Aspektin e vet më të dukshëm, autonomia e pushtetit vendor e shpreh në ndarjen e kompetencave, e cila ka të bëjë me iniciativën që kanë ose duhet të kenë, në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit, organet e qeverisjes vendore për të vendosur vetë për problemet që hyjnë në juridiksionin e tyre (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vëren se standardet e përgjithshme të evidentuara më sipër janë reflektuar edhe në ligjin nr. 10119/2009, i cili ka për objekt përcaktimin e parimeve bazë, përgjegjësive, rregullave dhe procedurave për planifikimin e territorit (neni 2). Sipas tij, planifikimi i territorit është një veprimtari ndërdisiplinore për planifikimin e përdorimit të tokës, përcaktimin e kushteve për zhvillimin e territorit dhe të strukturave natyrore e të ndërtueshme në të, kurse instrumentet e planifikimit janë politikat, planet dhe rregulloret, që zbatohen në mënyrë të përgjithshme ndaj një territori, pjesë të tij apo ndaj një tipi zhvillimi (neni 3, pikat 1 dhe 2). Po në bazë të këtij ligji,

nivelet e instrumenteve të planifikimit përfshijnë planifikimin kombëtar dhe atë vendor. Instrumentet kombëtare të planifikimit përcaktojnë ose orientojnë zhvillimin e ardhshëm, në të gjithë territorin kombëtar ose në një pjesë të tij, kushtet e zhvillimit të strukturave të përfshira në to dhe vendndodhjen e përbërësve kryesorë të infrastrukturës publike kombëtare (neni 26). Kurse instrumentet vendore të planifikimit përcaktojnë zhvillimin e ardhshëm në të gjithë ose në një pjesë të territorit vendor, kushtet e zhvillimit të strukturave të përfshira në to dhe vendndodhjen e përbërësve kryesorë të infrastrukturës publike, për trajtimin e çështjeve të rëndësishme, vendore e kombëtare, të deleguara (neni 27). Plani i Përgjithshëm Kombëtar zbatohet në të gjithë territorin kombëtar dhe hartimi e miratimi i tij mbështeten në planet kombëtare, ndërsektoriale dhe sektoriale, në rastet kur këto janë miratuar më parë, kurse instrumentet vendore të planifikimit të territorit hartohen dhe miratohen në përputhje me instrumentet kombëtare të planifikimit të territorit, si dhe me instrumentet e planifikimit të njësisë kufizuese të qeverisjes vendore për çështje të rëndësishme së përbashkët.

22. Ligji i ka ndarë autoritetet e planifikimit të territorit në autoritete kombëtare dhe vendore, duke parashikuar edhe kompetencat e tyre. Sipas nenit 5 të ligjit, autoritetet kombëtare të planifikimit të territorit janë Këshilli i Ministrave, KKT-ja, AKPT-ja si dhe çdo organ publik qendror që ka detyra dhe përgjegjësi në planifikimin e territorit ose i janë deleguar detyra e përgjegjësi të caktuara për planifikimin e territorit dhe kontrollin mjedisor. Këto autoritete ushtrojnë funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse, që burojnë nga dhe/ose bazohen në legjislacionin në fuqi për çështje të rëndësishme kombëtare të planifikimit të territorit. Sipas nenit 8 të ligjit, KKT-ja është organi vendimmarrës përgjegjës për miratimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit të territorit. Për sa u përket autoriteteve vendore të planifikimit, neni 12 i ligjit parashikon se ato janë bashkia/komuna, qarku dhe organet, që janë në varësi të bashkisë/komunës/qarkut, të cilat ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në të gjithë territorin e tyre administrativ.

23. Përveç sa më sipër, ligji ka parashikuar edhe instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit, që miratohen e zbatohen nga autoritetet e



planifikimit për të garantuar një interes publik. Njëri prej tyre është edhe pezullimi i zhvillimit, që nënkupton ndalimin e përkohshëm të zhvillimit ose shtyrjen e shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimi, në të gjithë territorin ose në një pjesë të tij për një, disa ose çdo tip zhvillimi, në mënyrë që të ruhet territori në fjalë gjatë periudhës së hartimit të një instrumenti të planifikimit (neni 3, pika 39/a). Neni 63 i ligjit e ka përcaktuar pezullimin e zhvillimit si një ndër instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit në territor, të cilat zbatohen kur është i domosdoshëm realizimi i një qëllimi apo përdorimi publik të dokumentuar dhe kur rezultojnë të jetë metoda e vetme, e përshtatshme për realizimin e tij. Sipas nenit 64, pezullimi i zhvillimit përdoret, në proporcion me rrethanat që e diktojnë atë, vetëm kur rezultojnë se instrumente të tjera në fuqi nuk do të jepnin një zgjidhje të përshtatshme. Autoriteti i planifikimit mund të vendosë pezullimin e zhvillimit gjatë miratimit të nismës për hartimin e instrumentit të planifikimit ose gjatë procesit të hartimit të tij.

24. Gjykata ka theksuar se vetëqeverisja vendore paraqitet me një status kushtetues që konsiston, midis të tjerave, në ushtrimin nga organet e qeverisjes vendore të funksioneve brenda juridiksionit të tyre, pa ndërhyrjen e organeve të pushtetit qendror (neni 113 i Kushtetutës), në ekzistencën e mjeteve financiare dhe të mjeteve të tjera, me të cilat ajo disponon në mënyrë të pavarur (nenet 111, 113, shkronjat “b”, “c”, “ç”, të Kushtetutës) (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 21.12.2006*). Në jurisprudencën kushtetuese, për çështje që kanë pasur për objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, Gjykata ka konkluduar se planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës janë kompetenca të plota dhe ekskluzive të autoriteteve vendore dhe përfshihen në konceptin ligjor “funksionet e veta”, sipas të cilit, nëpërmjet lirisë dhe autoritetit për të marrë vendime, ato janë përgjegjëse për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 29, datë 21.12.2006 dhe nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pezullimi i dhënies së lejeve zhvillimore konsiderohet *prima facie*, një masë që ndërhyr në ushtrimin e funksioneve të veta nga ana e autoriteteve vendore.

25. Gjykata ka theksuar se shumë çështje kanë implikime si vendore, ashtu edhe kombëtare dhe përgjegjësi për to ndryshon në hapësirë dhe në kohë dhe, për më tepër, kjo përgjegjësi mund të ndahet edhe ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Gjithsesi, kufizimi i veprimtarisë së autoriteteve vendore vetëm në çështje që nuk kanë implikime të gjera, mbart rrezikun për t'i shndërruar ato në autoritete me një rol të parëndësishëm. Nga ana tjetër, është e nevojshme që pushtetit qendror t'i rezervohen disa funksione të rëndësishme me rëndësi kombëtare e strategjike. Përcaktimi i interesit të komunitetit lidhet edhe me nevojën e ekzistencës së kufijve për vetë pushtetin vendor, i cili nuk duhet të tejkalojë kompetencat e tij duke vendosur për çështje që i përkasin një vendimmarrjeje të pastër politike ose për çështje që kanë pasoja ekonomike për të gjithë vendin dhe jo vetëm për komunitetin vendor përkatës. Është e lejueshme që çështje me rëndësi kombëtare e strategjike për interesat e vendit dhe që lidhen me miratimin e masterplaneve dhe të studimeve urbanistike rajonale e më gjerë, të ushtrohen nën autoritetin e pushtetit qendror, i cili është përgjegjës për politikën e zhvillimit ekonomik e politik të vendit. Megjithatë, do të konsiderohej si cenim i të drejtës për vetëqeverisje të pushtetit vendor, nëse ligjvënësi, duke u hequr kompetenca organeve vendore, do ta dobësonte aq shumë rolin e këtyre sa që ekzistenca ose vetëqeverisja e tyre do të bëheshin të pandjeshme (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se e drejta e pezullimit të zhvillimit është një kompetencë që ligji ia ka njohur autoritetit përkatës të planifikimit, i cili mund të jetë ai kombëtar apo vendor, në varësi të instrumentit të planifikimit. Sipas nenit 32 të ligjit, KKT-ja, me propozimin e AKPT-së, përcakton një çështje si të rëndësishme kombëtare në planifikim dhe dispozita përcakton edhe procedurën që ndiqet deri në miratimin e aktit si dhe të drejtën e pezullimit, në bazë të nenit 64 të ligjit, në rastet kur ka një rrezik të qartë e emergjent ndaj interesave, karakteristikave apo funksioneve kombëtare të objektit apo të zonës, për të cilin propozohet përcaktimi si i rëndësishme kombëtare në planifikim. Në këtë kuptim, në rastin konkret,





KKT-ja, si një nga autoritetet kombëtare të planifikimit dhe autoriteti përgjegjës për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, ka vendosur pezullimin e lejeve të zhvillimit në zona që janë vlerësuar se paraqesin rëndësi kombëtare në planifikim. Sipas subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, arsyet për miratimin e vendimit nr. 5/3013 janë gjendja e emergjencës në territor, si pasojë e mungesës së kontrollit apo abuzimeve me pasuritë e vlerat e trashëgimisë ambientale, kulturore dhe historike, deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.

27. Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk është cenuar parimi i autonomisë vendore, pasi organi i pushtetit qendror ka ushtruar një kompetencë të tijen ligjore, në përputhje me përcaktimet e ligjit për planifikimin e territorit. Nëpërmjet këtij vendimi KKT-ja nuk ka përcaktuar zona të reja me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe nuk ka marrë ose ushtruar asnjë kompetencë tjetër, të cilën ligji ua ka njohur autoriteteve të qeverisjes vendore dhe që lidhet me menaxhimin dhe kontrollin e territorit në administrim. Ndërsa pezullimi i përkohshëm i dhënies së lejeve zhvillimore u referohet vetëm zonave me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore e historike, organet e qeverisjes vendore nuk pengohen në ushtrimin e kompetencave në pjesën tjetër të territorit të tyre. Edhe pse pezullimi i dhënies së lejeve zhvillimore në disa zona të caktuara sjell një pengesë të përkohshme në ushtrimin e funksioneve të organeve të qeverisjes vendore, kjo ndërhyrje është e justifikuar nga rëndësia e çështjes që rregullohet.

28. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se vendimi nr. 5/2013 është në kundërshtim me nenin 64 të ligjit nr. 10119/2009, pasi sipas këtij vendimi afati i pezullimit është i papërcaktuar, ndërkohë që ligji ka parashikuar një afat maksimal prej 12 muajsh.

29. Parimi i shtetit të së drejtës i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, marrëdhëniet midis normave juridike bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre dhe respektimi i hierarkisë së akteve normative

është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 17.2.2012 dhe nr. 20, datë 4.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata vëren se bazuar në nenin 64/4 të ligjit nr. 10119/2009, pezullimi i zhvillimit mund të vendoset për një periudhë kohore deri në 12 muaj dhe ai mund të zgjatet edhe për 6 muaj të tjerë, për shkaqe specifike të përligjura. Në këto kushte, për sa kohë që afati brenda të cilit mund të zbatohet një instrument i tillë kontrolli i territorit është parashikuar nga norma ligjore, fakti që ai nuk ka gjetur pasqyrim në vendimin nr. 5/2013, nuk e bën këtë akt të cenueshëm. Për sa më sipër, ky pretendim i kërkuetit është i pabazuar.

31. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuetit, që lidhen me mospasjen e një njoftimi për nisjen e ndonjë procedure për shpalljen e zonave të rëndësisë kombëtare, mospërcaktimin e objektit dhe/ose të zonës konkrete dhe kufijve apo vendit në territor të tyre, apo lidhur me organin kompetent për miratimin e vendimit nr. 5/2013, Gjykata vlerëson se janë çështje që lidhen me ligjshmërinë dhe vlefshmërinë e aktit të kundërshtuar dhe, si të tilla, nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë gjyqësor administrativ.

32. Në përfundim, për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e paraqitura nga Bashkia e Tiranës janë të pabazuara dhe, për pasojë, kërkesa e paraqitur prej saj duhet të rrëzohet.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “ç” dhe 134, pika 1, shkronja “e” të Kushtetutës, si dhe të neneve 54, 55, 56, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Gjyqtari S. Berberi votoi për rrëzimin e kërkesës për mungesën e juridiksionit kushtetues me argumentin se kërkuesi, në thelb, kërkon kontrollin e ligjshmërisë së aktit individual të kundërshtuar, për të cilin, kërkuesi mund t'i drejtohet juridiksionit administrativ gjyqësor.



- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Altina Xhoxhaj.

## VENDIM

Nr. 55, datë 5.12.2014

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 3.6.2014, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 23 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Artan Treska, Etleva Goga (Maliqi), Florika Maliqi

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Viktori Qirjazi, Brikena Qirjazi, Qirjako Qirjazi, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 240, datë 8.2.2012, të Gjykatës së Lartë; nr. 530, datë 20.12.2010, të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 2000, datë 30.7.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 41, 42, 131/f dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 29, 30, 31 dhe 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Shqipërisë”.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e

subjekteve të interesuara, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

#### I

1. Kërkuësit kanë paraqitur një padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, duke paditur subjektet e interesuara, prej të cilëve kanë kërkuar: Njohjen si bashkëtrashëgimtarë në 3/4 pjesë të truallit me sipërfaqe 900 m<sup>2</sup>, të ndodhur në qytetin e Korçës, të pasurisë së ish-pronares PM, të njohur, të kthyer e të kompensuar me vendimin nr. 275, datë 2.5.2003, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Korçë (në vijim KKKP) dhe me vendimin nr. 632, datë 21.4.1995, të KKKP Korçë. Dorëzimin e pjesës përkatëse të kësaj pasurie trashëgimore, duke urdhëruar subjektin e interesuar Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme, Korçë (në vijim ZVRPP) të bëjë regjistrimin e 3/4 pjesë të pasurisë trashëgimore në emër të tyre.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2010-3174 (2000), ka vendosur: “*Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurve Viktori Qirjazi, Brikena Qirjazi, Qirjako Qirjazi, të njohin bashkëpronarë për shkak trashëgimie paditësit Artan Treska, Etleva Goga, Florika Maliqi, mbi pasurinë e paluajtshme regjistruar në ZRPP Korçë, me nr. 5/276 pasurie, zona kadastrale nr. 8563, vol.19, faqe 232, me sipërfaqe 900 m<sup>2</sup>, ndodhur në Korçë, në rrugën “Papa Kristo Negovani”, e më konkretisht të dorëzojnë pjesën prej 202,8 m<sup>2</sup> nga ky truall. Rrëzimin e padisë për pjesët e tjera të saj. Regjistrimin e këtij vendimi gjyqësor dhe disponimeve të tij në ZRPP Korçë, pasi të marrë formë të prerë.*”

3. Mbi ankimin e paraqitur nga kërkuësit dhe subjektet e interesuara, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 530, datë 20.12.2010, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 2000, datë 30.7.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për sa i përket pjesës së rrëzuar të padisë së kërkuësve Artan Treska, Etleva Goga dhe Florika Maliqi. Ndryshimin e pjesës tjetër të këtij vendimi si më poshtë: Rrëzimin e padisë së kërkuësve për sa i përket kërkitimit për pasurinë trashëgimore në emër të trashëgimlënësës Dhimitra Maliqi.*”

4. Mbi rekursin e paraqitur nga kërkuësit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2012-240, datë



8.2.2012, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Artan Treska, Etleva Gogo dhe Florika Maliqi, kundër vendimit nr. 530, datë 20.12.2010, të Gjykatës së Apelit Korçë.”.

## II

5. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e të tre vendimeve objekt kërkese. Ata kanë parashtruar se:

5.1 Gjykata e Lartë nuk e ka arsyetuar vendimin e saj të mospranimin të rekursit. Neni 142 i Kushtetutës, i detyron gjykatat e të gjitha niveleve për të arsyetuar vendimet e tyre. Duke qenë akti më i rëndësishëm procedural, vendimi duhet të pasqyrojë arsyet e marrjes së tij. Funkzioni i vendimit të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Nga ana tjetër, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të realizohet një kontroll publik i administrimit të drejtësisë.

5.2 Vendimet gjyqësore janë rezultat i zbatimit të keq të ligjit material. Kërkuesit pretendojnë se në bazë të dëshmisë së trashëgimisë të lëshuar për të ndjerat Dhimitra Maliqi (Gjini) dhe Ollga Maliqi, ata janë trashëgimtarë të gjyshes së tyre dhe tezes së babait të tyre. Ndërkohë që gjykatat që kanë gjykuar themelin e çështjes, nuk i kanë zbatuar saktësisht dispozitat mbi trashëgiminë ligjore, duke njohur si trashëgimtarë vetëm njërin nga vajzat e Dhimitrës, Viktorinë dhe familjen e saj (Brikenën, vajzën e saj, dhe Qirjakon, bashkëshortin);

5.3 Gjykatat nuk i kanë mbështetur vendimet e tyre në provat e administruara gjatë gjykimit, duke shkelur parimin e kontradiktoritetit. Gjykata e Apelit Korçë, ka dhënë vendimin duke u bazuar në kontratën e dhurimit të dhurueses Dhimitra Maliqi, por duke dalë tej përcaktimeve të kësaj kontrate.

5.4 Gjykata e Apelit Korçë, duke mos thirrur ekspertë topografë për të përcaktuar pozicionin dhe kufijtë e pronës, ka dalë tej kompetencave të saj duke konkluduar se në kontratën e dhurimit kufizimet e pronës së dhuruar nuk janë me ato të pronës objekt shqyrtimi.

6. **Subjektet e interesuara** kanë parashtruar se kërkesa e paraqitur nga kërkuesit nuk është e bazuar, pasi të tre vendimet gjyqësore janë dhënë në respektim të plotë të parimit për një proces të rregullt ligjor.

6.1 Rekursi i paraqitur nga kërkuesit ka qenë me terma të paqarta dhe në përgjithësi për interpretim e zbatim të gabuar të ligjit, por pa caktuar konkretisht e qartësisht dispozitat dhe argumentet lidhur me to. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë e ka pasur të pamundur pasqyrimin e tyre, me qëllim për të treguar se ato janë shqyrtuar.

6.2 Pala kërkuese ka kërkuar dhe shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, por nuk ka paraqitur ndonjë argument në mbështetje të këtij kërkimi.

6.3 Pretendimi për zbatim të keq të ligjit nga gjykatat nuk hyjnë në sferën e shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese. Ky pretendim ka marrë përgjigje të plotë nga Gjykata e Apelit dhe nuk është ngritur konform rregullave procedurale në rekurs.

## III

### VLERËSIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

#### A. Për legjitimin e kërkuesve

7. Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen si subjekte për të paraqitur një kërkesë të tillë para kësaj gjykate, pasi parashikohen si subjekte nga neni 134/1, “g” i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*ratione personae*), ata e kanë paraqitur kërkesën brenda afatit 2-vjeçar nga dita e dhënies së vendimit gjyqësor të fundit, si dhe pretendimi që ata ngrenë lidhur me të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është një e drejtë e njohur dhe e mbrojtur nga Kushtetuta.

#### B. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

8. Kërkuesit pretendojnë se Gjykata e Lartë me vendimin e mospranimin të rekursit, pa dhënë ndonjë argument lidhur me pretendimet e tyre, ka cenuar të drejtën e tyre për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, e drejtë e cila rrjedh nga detyrimi që kanë gjykatat për të arsyetuar vendimet e tyre, parashikuar nga neni 142 i Kushtetutës.

9. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar si dhe



u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 37, datë 30.6.2014, nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka nënvizuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 7, datë 9.3.2009 dhe nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik

(*shih vendimet nr. 37, datë 30.6.2014, nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Gjykata vë në dukje se ajo e vlerëson arsytimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Neni 310/1 i KPC-së parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni 475/ç) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit (neni 480).

14. Nga parashikimet e normave procedurale civile, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që



përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili, në këtë drejtim, duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi nr. 240, datë 8.2.2012, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, përmban në pjesën hyrëse të tij, palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit kanë paraqitur rekurs kërkuessit, por nuk përmban shkaqet që ata kanë parashtruar në rekurs. Ndërsa në pjesën arsyetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me përfundimin se “rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së” duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij. Pra, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se në vendim nuk paraqet se cilat janë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të apelit, ka arritur të bëjë një proces vlerësimi të tyre nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv.

16. Gjykata, nisur dhe nga sa u argumentua më lart dhe duke iu referuar jurisprudencës së saj, çmon gjithashtu se, *prima facie*, mosparaqitja, në vendimin e Kolegjit Civil, e shkaqeve të parashtruara nga kërkuessi në rekurs, krijon dyshime edhe mbi cenimin e të drejtës së ankimit efektiv si dhe të të drejtës për t’u dëgjuar, të pretenduara nga kërkuessi. Në këtë këndvështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 15, datë 19.4.2013 dhe nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nga analiza në tërësi e vendimit, Gjykata vlerëson se, për shkakun e lartpërmendur, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), pavarësisht se në vendim nuk paraqet cilat janë shkaqet e

kundërshtimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka arritur të bëjë një proces vlerësimi të shkaqeve, nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv. Gjykata vlerëson se pjesët e vendimit nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda tij, ç’ka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë një harmoni të brendshme.

18. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës, duke krijuar dyshime edhe për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuessve.

#### C. Për pretendimet e tjera

19. Lidhur me pretendimet e tjera të kërkuessit për zbatimin e keq të ligjit material nga gjykatat e zakonshme, mosrespektimin e parimit të kontradiktoritetit, si dhe daljen jashtë kompetencave të tyre, Gjykata thekson se është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivoqe në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të kërkuessve.

20. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, rikonfirmon qëndrimin se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 19, datë 2.4.2012 dhe nr. 4, datë 28.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i mospranimit të rekursit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuessve në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.



## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “P”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

## VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës<sup>2</sup>
- Shfuqizimin e vendimit nr. 240, datë 8.2.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtare kundër: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha

## MENDIM PARALEL

1. Edhe pse në konkluzion përfundimtar jam dakord me shumicën që është shprehur për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-240, datë 8.2.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) si të papajtueshëm me nenin 42 të Kushtetutës, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me argumentin e përdorur për shfuqizimin. Kështu, shumica shprehet se: “Gjykata çmon se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsytimit të gjykatës, duke krijuar dyshime edhe për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuësve”. (*paragrafi 18 i vendimit*).

<sup>2</sup> Gjyqtarët Bashkim Dedja dhe Vladimir Kristo janë shprehur me mendim paralel. Gjyqtari V. Kristo votoi pro pranimit të kërkesës me argumentin se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit sipas qëndrimit të shprehur në mendimin paralel të vendimit nr. 28, datë 15.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

2. Kërkuësit kanë pretenduar edhe zbatim të keq të ligjit material nga gjykatat e zakonshme. Sipas tyre, në bazë të dëshmisë së trashëgimisë të lëshuar për të ndjerat Dhimitra Maliqi (Gjini) dhe Ollga Maliqi, ata janë trashëgimtarë të gjyshes së tyre dhe tezes së babait të tyre. Ndërkohë që gjykatat të cilat kanë gjykuar themelin e çështjes, nuk i kanë zbatuar saktësisht dispozitat mbi trashëgiminë ligjore, duke njohur si trashëgimtarë vetëm njërën nga vajzat e Dhimitrës, Viktorinë, dhe familjen e saj (Brikenën, vajzën e saj, dhe Qirjakon, bashkëshortin) (paragrafi 5.2). Gjithashtu, sipas kërkuësve, gjykatat nuk i kanë mbështetur vendimet e tyre në provat e administruara gjatë gjykimit, duke shkelur parimin e kontradiktoritetit. Gjykata e Apelit Korçë e ka dhënë vendimin duke u bazuar në kontratën e dhurimit të dhurueses Dhimitra Maliqi, por duke dalë tej përcaktimeve të kësaj kontrate (paragrafi 5.3).

3. Sipas nenit 472/1,2 të KPC-së, rekursi mund të bëhet edhe kur: a) nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji; dhe b) ka shkelje të rënda të normave procedurale. Sipas mendimit tim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të kishte dhënë një “minimum arsyeje” për mospranimin e këtyre pretendimeve të lidhura me keqzbatimin e ligjit, me shkeljen e normave procedurale, si dhe me daljen jashtë përcaktimeve kontraktuale, e cila përbën ligj për palët dhe duke mos e respektuar cenon edhe parimin e sigurisë juridike, përderisa ato përbënin shkak, prima facie, për pranim rekursi sipas kërkesave të nenit 472 të KPC - së.

4. Në rastin konkret, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë jo vetëm nuk jep arsye për mospranim, por as nuk përmend se çfarë pretendimesh konkrete kanë ngritur kërkuësit para Gjykatës së Lartë e që janë të papranueshme, çfarë e bën vendimin të parregullt në formë, të paqartë në përmbajtje dhe tërësisht të paarsyetuar. Për më tepër, që edhe qëndrimet e dy gjykatave më të ulëta, respektivisht të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatës së Apelit Korçë, janë të ndryshme në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

5. Për rrjedhojë, vendimit nr. 00-2012-240, datë 8.2.2012 të Dhomës së Këshillimit të Kolegjit Civil i mungon një minimum arsytimi, duke cenuar të drejtën e kërkuësve për proces të



rregullt ligjor. Prandaj kërkesa e tyre, në gjykimin tim, duhej pranuar nga Gjykata Kushtetuese edhe për këtë argument.

Bashkim Dedja (kryetar)

**VENDIM**  
**Nr. 56, datë 5.12.2014**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina (Çinari) Basha, në datën 17.9.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 40 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Niko Rrotani

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Ndoc Molla, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Komunës Bushat-Shkodër

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 3530, datë 29.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 113, datë 5.3.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 1640, datë 12.7.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi)

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 43 dhe 131/f të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Besnik Imeraj, parashtrimet me shkrim të kërkuarit, Niko Rrotani, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ndoc Molla dhe Komuna Bushat

Shkodër, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

**I**

1. Komuna Bushat-Shkodër, me vendimin nr. 1, datë 28.12.2006 të KRT-së, i ka dhënë kërkuarit Niko Rrotani të drejtën për ndërtimin e një stalle derrash në pronën e tij. Pasi është përfunduar ndërtimi në fjalë, subjekti i interesuar, Ndoc Molla i është drejtuar gjykatës me padinë që ka si objekt, anulimin e aktit administrativ nr. 1, datë 28.12.2006, të KRT-së në komunën Bushat, duke pretenduar se stalla e derrave e ndërtuar nga kërkuari i cenon pronësinë mbi pasurinë e tij të paluajtshme, shtëpi banimi, për shkak të erës së rëndë që vjen nga stalla në fjalë. Ka rezultuar se shtëpia e banimit e subjektit të interesuar Ndoc Molla ndodhet jo më shumë se 350 m larg objektit të ndërtuar nga kërkuari Niko Rrotani.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 3530, datë 29.12.2008 ka pranuar pjesërisht padinë duke e detyruar kërkuarin Niko Rrotani, që të ndalojë ushtrimin e aktivitetit të mbarështimit të derrave në objektin ndërtimor të ngritur në bazë të lejes së ndërtimit të lartpërmendur. Gjykata e Apelit Shkodër ka lënë në fuqi vendimin nr. 3530, datë 29.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 1640, datë 12.7.2013 (dhomë këshillimi) ka vendosur mospranimin e rekursit të bërë nga kërkuari Niko Rrotani.

**II**

3. **Kërkuari** Niko Rrotani i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

3.1 Është cenuar e drejta për t'u përfaqësuar dhe dëgjuar në gjykim.

3.2 Është cenuar e drejta e pronës dhe e drejta e ushtrimit të aktivitetit ekonomik të ligjshëm.

3.3 Gjykata ka gjykuar në mënyrë të njëanshme, në favor të paditësit.

3.4 Është cenuar parimi i sigurisë juridike pasi leja e dhënë ka qenë konform ligjit.

3.5 Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është i arsyetuar.



3.6 Gjykatat kanë dalë jashtë objektit të padisë.

3.7 Padia nuk është mbështetur në ligj, leja e KRT është e rregullt, nuk është konsumuar procedura administrative nga paditësi dhe nga ndërtimi i objektit nuk i është cenuar e drejta e pronësisë.

3.8 Paditësi nuk legjitimohet për të ngritur një padi me objekt kundërshtimin e aktit administrativ, leje ndërtimi, pasi nga ndërtimi i objektit nuk është cenuar e drejta e pronësisë.

4. **Subjekti i interesuar** Ndoc Molla ka parashtruar si më poshtë:

4.1 Kërkuesi Niko Rrotani nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 3530, datë 29.12.2008, pra nuk ka ezauruar të gjitha mjetet juridike të ankimit, përpara se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese.

4.2 Kërkuesi ka pasur dijeni për të gjithë procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij.

4.3 Rezulton që gjykatat kanë konstatuar se leja e ndërtimit nr. 1, datë 29.12.2006 është një akt absolutisht i pavlefshëm.

4.4 Arsyetimi i vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk paraqet mangësi pasi forma e arsyetimit të vendimeve të mospranimit të rekursit është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë.

4.5 Vendimi i Gjykatës së Apelit ka analizuar dhe arsyetuar edhe në lidhje me lejen mjedisore të dhënë kërkuesit.

5. **Subjekti i interesuar, Komuna Bushat,** parashtron si më poshtë:

5.1 Padia nuk është mbështetur në ligj, nuk është konsumuar procedura administrative nga paditësi dhe nga ndërtimi i objektit nuk i është cenuar e drejta e pronësisë.

5.2 Leja e ndërtimit dhe të gjitha aktet e tjera të dhëna në favor të kërkuesit janë konform legjislacionit në fuqi.

### III

#### VLERËSIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

##### A. Për legjitimitimin

6. Bazuar në nenin 131, shkronja “P”, të Kushtetutës, individit mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”) për gjykimin përfundimtar të pretendimeve për cenimin e të

drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Shterimi i mjeteve kërkon që individit të shfrytëzohet në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për rivendosjen e të drejtave të pretenduara. Ai përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga kërkuesi, përpara se t'i drejtohet Gjykatës. Ky rregull nënkupton jo vetëm që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 6, datë 4.3.2010; nr. 15, datë 19.4.2013; nr. 28, datë 15.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Gjykata konstaton se në çështjen objekt shqyrtimi, kërkuesi, për disa nga pretendimet e ngritura, nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore, pasi pretendimet nuk janë parashtruar fillimisht në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Kështu pretendimet lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike, paanshmërinë e gjykatës dhe cenimin e së drejtës së pronës, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nuk janë pretenduar në rekursin e kërkuesit para Gjykatës së Lartë. Për këto arsye kërkuesi nuk legjitimohet për këto pretendime.

8. Kërkuesi legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me pretendimet për sa i përket, cenimit të së drejtës për t'u përfaqësuar e dëgjuar si dhe në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për një vendim të arsyetuar. Kërkuesi legjitimohet dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji. Në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, individit, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese brenda 2 vjetëve nga data e njoftimit të vendimit të fundit të organit përkatës shtetëror. Në rastin në shqyrtim, vendimi më i fundit në kohë është vendimi nr. 1640, datë 12.7.2013, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.





*B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar e përfaqësuar në gjykim*

9. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për t'u përfaqësuar dhe dëgjuar në gjykim.

10. Gjykata, në jurisprudencën e saj është shprehur se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. E drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake, në raport me palën kundërshtare. Ajo i paraprin të drejtave të tjera, pasi, nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 18, datë 23.4.2013; nr. 34, datë 25.7.2011 dhe nr. 34 datë 3.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkon që secilës palë në gjykim t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta sipas kushteve, të cilat nuk e vendosin në disavantazh ndaj kundërshtarit. Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata ka theksuar se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelle thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces (shih vendimin nr. 5, datë 25.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në çështjen objekt shqyrtimi konstatohet se kërkuesi, Niko Rrotani i ka dhënë shtetasit Ç.L. një prokurë për ta përfaqësuar në gjykim, por rezulton se me gjithë kërkesën e trupit gjykues për riparimin e të metave në këtë prokurë, shtetasi Ç. L. duke pasur dijeni për datën e seancës gjyqësore, nuk është paraqitur në seancën e datës 17.11.2008. Për këto arsye dhe gjykimi ka vazhduar në mungesë të këtij shtetasi dhe gjykata është detyruar të bëjë dhe shpalljen për njoftimin e kërkuesit Niko Rrotani.

15. Për këto arsye, pretendimet e kërkuesit Niko Rrotani për cenim të së drejtës për t'u dëgjuar e përfaqësuar janë të pabazuara.

*C. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsytimit të vendimit në Gjykatën e Lartë*

16. Kërkuesi pretendon se ky standard është cenuar pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar.

17. Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Gjyqësori, në kryerjen e funksioneve i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve dhe vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara (neni 142 i Kushtetutës). Vendimet duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsytimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve" (*shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimin nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).



19. Në lidhje me detyrimin për arsyetimin e vendimeve të dhomës së këshillimit që vendosin mospranimin e rekursit, Gjykata dhe GJEDNJ-ja kanë vlerësuar se ky lloj arsyetimi i vendimit të dhomës së këshillimit nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila mund të ndikojë negativisht në këtë drejtim. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimin nr. 35, datë 5.3.2002 të Gjykatës Kushtetuese*). GJEDNJ-ja vëren, gjithashtu, se arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulën e saj të vendimeve de plano, tregon se kërkuesi nuk ka ngritur ndonjë nga shkaqet ligjore të parashikuara në dispozitat përkatëse ligjore, çka përbën një kërkesë pranueshmërie për ankimin. GJEDNJ-ja vëren se aty ku një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje mbi bazën se nuk ka shkaqe ligjore një arsyetim shumë i kufizuar mund të plotësojë kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së (*vendimet e GJEDNJ-së në çështjen Marini v. Shqipërisë, datë 7 Korrik 2008, § 106; në çështjen Mishajoni v. Shqipërisë, datë 7 Dhjetor 2010, § 51*).

20. Gjykata vlerëson se, bazuar në këto standarde, nuk rezulton që vendimi i Gjykatës së Lartë objekt kërkesë të jetë jo logjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementët e përmendur më sipër.

21. Në rastin konkret, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, në pjesën hyrëse përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit si dhe përmban shkaqet që kërkuesi ka parashtruar në rekurs. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se dhe ky pretendim është i pambështetur në argumentet kushtetuese.

#### *D. Për pretendimet e tjera*

22. Kërkuesi pretendon se gjykatat nuk kanë vlerësuar lejen e dhënë në mënyrë të ligjshme, nuk është ndjekur procedura administrative etj.

23. Gjykata Kushtetuese tashmë ka konsoliduar qëndrimin se kërkesa për marrje provash jo domosdoshmërisht duhet të pranohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe se vlerësimi i tyre është kompetencë e këtyre gjykatave (*shih vendimet nr. 47, datë 7.11.2011 dhe nr. 37, datë 19.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 52, datë 2.12.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë.

25. Gjykata ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave, interpretimi i ligjit material dhe procedural dhe aplikimi i tij në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Për sa i përket mënyrës se si janë interpretuar dhe vlerësuar provat nga gjykatat e zakonshme, kjo çështje nuk përbën objekt kontrolli për këtë Gjykatë, sepse ajo mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, por jo për mënyrën e vlerësimit (*shih vendimet nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 37, datë 19.9.2011*).

26. Gjykata vlerëson se pretendimi i ngritur nga kërkuesi lidhet me çështje të vlerësimit të provave në gjykimin e faktit. Ai përfshin vlerësime që lidhen me çështje të themelit, konkretisht me ligjshmërinë e lejes së ndërtimit, e cila nuk mund të bëhet objekt i gjykimit kushtetues dhe për pasojë, edhe ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

27. Gjykata arrin në përfundimin se, në tërësinë e tij, procesi i zhvilluar në të tri shkallët e gjykimit ka qenë i rregullt në aspektin kushtetues. Si pasojë pretendimet e kërkuesit nuk duhet të pranohen.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f” dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe



funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

**VENDOSI:**

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha  
Anëtare kundër: Vitore Tusha

**VENDIM**  
**Nr. 57, datë 5.12.2014**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 21.10.2014, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 43 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se një e pesta e deputetëve).

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

**OBJEKTI:** 1. Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 354, datë 4.6.2014 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e bazës së të dhënave IMEI për regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme”.

2. Pezullimi i vendimit nr. 354, datë 4.6.2014 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e bazës së të dhënave IMEI për regjistrimin e numrave

IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme”.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 17, 35, 36, 118, 131/c dhe 134/c të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, jo më pak se 1/5 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë dhe të subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Këshilli i Ministrave, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 5 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozim të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, ka miratuar vendimin nr. 354, datë 4.6.2014 “Për ngritjen e bazës së të dhënave IMEI për regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme” (më poshtë: VKM nr. 354/2014).

2. Referuar titullit, objektit të rregullimit të dispozitave, si dhe përmbajtjes së VKM-së nr. 354/2014, në thelb, ajo ka si qëllim detyrimin e regjistrimit të aparateve celulare nëpërmjet numrit IMEI, që përdoret në rrjetet që ofrojnë shërbime të lëvizshme; ofrimin e shërbimit vetëm me aparate me numra IMEI të regjistruar; ngritjen e bazës së të dhënave për numrat IMEI pranë Ministrisë së Financave; përcaktimin e organeve të cilave u jepet e drejta e aksesit në Bazën e të Dhënave, që duhet të autorizohet nga Ministri i Financave dhe ndërprerjen e ofrimit të shërbimit, nga ana e operatorëve të telefonisë celulare, nëse numri IMEI rezulton i paregjistruar.

## II

3. **Kërkuesi, jo më pak se 1/5 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e VKM-së nr. 354/2014 si antikushtetuese dhe paraqet, në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe në mbështetje të pretendimit të tij:

*Për legjitimitimin*

3.1 Kërkuesi parashtron se legjitimohet në paraqitjen e kërkesës për shfuqizimin si antikushtetuese të VKM-së nr. 354/2014, pasi plotëson kriterin numerik të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja “c”, që parashikon se “Gjykata vibet në lëvizje vetëm me kërkesë të ... c) jo më pak se 1/5 e deputetëve”. Po ashtu, sipas kërkuesit, grupi i deputetëve plotëson edhe kriterin tjetër që ka të bëjë me pasjen e qëllimit dhe të nxitjes konkrete për të kërkuar kontrollin abstrakt të normës, pasi Kushtetuta, në respekt të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ndër të tjera, e ngarkon Kuvendin e Shqipërisë me funksionin e kontrollit parlamentar për çështjet që përmbajnë në vetvete një interes publik. Një nga format e kontrollit, që buron nga neni 7 i Kushtetutës, është edhe mundësia që i njihet pakicës parlamentare për të vënë në lëvizje Gjykatën në rrugën e një kontrolli abstrakt kur vlerësohet se një akt normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

*Për themelin e kërkesës*

3.2 VKM-ja, objekt kundërshtimi, cenon parimin e shtetit të së drejtës dhe, konkretisht, parimin e hierarkisë së akteve normative dhe kriteret kushtetuese për nxjerrjen e akteve nënligjore. Ajo nuk gjen mbështetje në ligj dhe nuk është e autorizuar nga ligji, në kuptim të nenit 118 të Kushtetutës. Pavarësisht se VKM-ja nr. 354/2014 formalisht mbështetet në pikën 3, të nenit 5 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, asnjëra prej tyre nuk e autorizon Këshillin e Ministrave të miratojë një akt nënligjor që të përcaktojë rregulla për regjistrimin e numrit IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme, si dhe të krijojë bazat e të dhënave për numrat IMEI.

3.3 Vendimi objekt gjykimi bie ndesh me nenet 17, 35 dhe 36 të Kushtetutës. Mbledhja dhe përpunimi i të gjithë numrave IMEI të aparateve celulare si dhe autorizimi nga Ministri i Financave për aksesimin e këtyre të dhënave, përbëjnë cenim të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale, të sanksionuar nga neni 35 i Kushtetutës dhe neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

3.4 VKM-ja nr. 354/2014 cenon të drejtën e mbrojtjes së jetës private të personit dhe të fshehtësisë së komunikimit. Numri IMEI i aparatit celular përbën të dhënë me karakter personal dhe askush nuk është i detyruar ta bëjë publike këtë të dhënë, përveç rasteve të parashikuara në ligj. Nëse për arsye të mbrojtjes së interesit publik apo të të drejtave të të tjerëve, është i nevojshëm kufizimi i kësaj të drejte, ai mund të vendoset vetëm me ligj. Fakti që, në rastin konkret, ky kufizim është parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave, përbën tejkalim të kriterëve të përcaktuara në nenin 17 të Kushtetutës.

4. Kërkuesi ka kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të VKM-së nr. 354/2014, deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, me arsyetimin si më poshtë:

4.1 Veprimi i mëtejshëm i këtij akti do të detyrojë operatorët ekonomikë të transferojnë të dhënat konfidenciale të klientëve të tyre, si dhe, për shkak të penaltetit të sanksionuar, edhe vetë qytetarët të paraqesin numrin IMEI, duke cenuar të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale në mënyrë të pakthyeshme.

4.2 Sipas kërkuesit, akti ka dyshime të arsyeshme që bie ndesh me Kushtetutën, sepse Këshilli i Ministrave trajton detyrimin e mbledhjes së të dhënave personale, pavarësisht se nuk ka asnjë parashikim ligjor që të përcaktojë këtë detyrim.

4.3 Ekziston një urgjencë për pezullimin e aktit, sepse në të kundërt të dhënat personale të qytetarëve do të disponoheshin nga autoriteti publik.

4.4 Dëmi që mund t’u shkaktohet interesave të individëve është i rëndë dhe i pariparueshëm, pasi mbledhja e të dhënave nga autoriteti publik nënkupton mundësinë e disponimit të tyre përpara se Gjykata të shprehet për pajtueshmërinë me Kushtetutën të vendimit.



4.5 Pezullimi i aktit është në përputhje me interesin e përgjithshëm publik, si për shkak të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ashtu edhe sepse qytetarët mund të gjenden në një situatë të përdorimit të kundërligjshëm apo mosofritimit të shërbimit publik të komunikimeve elektronike.

5. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka prapësuar se vendimi i kundërshtuar është shfuqizuar me VKM nr. 642, datë 1.10.2014, që ka hyrë në fuqi në datë 8.10.2014.

6. **Subjekti i interesuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se në zbatim të kompetencave që i njeh ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, Komisioneri nuk ndalon krijimin e bazave të të dhënave, por mbikëqyr përpunimin e tyre. Në këtë drejtim VKM-ja objekt shqyrtimi, sipas Komisionerit, nuk kundërshtohet në bazë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithsesi, në fazën e mendimit paraprak, Komisioneri është shprehur dakord me miratimin e VKM-së nr. 354/2014.

### III

A. *Mbi kërkesën për pezullimin e zbatimit të VKM-së nr. 354/2014*

7. Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi për pezullimin e vendimit nr. 354, datë 4.6.2014 të Këshillit të Ministrave, në bazë të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, me vendimin e datës 17.9.2014, ka vendosur të urdhërojë pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 354, datë 4.6.2014 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e bazës së të dhënave IMEI për regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme” derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës të hyjë në fuqi.

### IV

#### VLERËSIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

B. *Mbi legjitimitetin e kërkuesit*

8. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 134/1, ka përcaktuar në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve kushtetuese, të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Kriteri kushtetues i “detyrimit për të

justifikuar interesin”, i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit të mësipërm, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori: subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në këtë kuptim, subjektet e parashikuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g” të paragrafit 1 të nenit 134, të cilat mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre, janë subjekte të kushtëzuara. Parashikimi i këtij kriteri kushtetues vetëm për një numër të kufizuar subjektësh kushtetuese, në një interpretim *a contrario*, do të thotë se ai nuk është i zbatueshëm për subjektet e tjera të parashikuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, të cilat nuk kanë detyrimin për të justifikuar interesin në rast se i drejtohen me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) të një të pestës së deputetëve ka qenë objekt i shqyrtimit nga kjo Gjykatë edhe në raste të tjera, në të cilat ajo, në mënyrë të vazhdueshme, ka vlerësuar se një e pesta e deputetëve përfaqëson një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1, shkronja “c” të Kushtetutës, të cilat kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret (*shih vendimin nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimin nr. 18, datë 29.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Nga sa më sipër, Gjykata, në asnjë rast, nuk e ka vënë në dyshim legjitimitetin e një të pestës së deputetëve kur ata i janë drejtuar kësaj Gjykate për kontrollin abstrakt të normës juridike. Për pasojë, edhe në rastin në shqyrtim, në referim të nenit 134/1, shkronja “c”, Gjykata çmon se jo më pak se 1/5 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë përfaqëson një subjekt me legjitimitet të pakushtëzuar dhe si i tillë legjitimohet të kërkojë kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së një akti normativ nënligjor.

C. *Mbi juridiksionin e Gjykatës*

11. Neni 131/c i Kushtetutës parashikon se Gjykata vendos për pajtueshmërinë e akteve



normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Bazuar në këtë kompetencë, Kolegji i Gjykatës vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Po ashtu, sikurse u përmend edhe më lart, lidhur me kërkesën e pezullimit të paraqitur nga kërkuesi, Mbledhja e Gjyqtarëve, në datën 17.9.2014, vendosi të urdhërojë pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 354, datë 4.6.2014 të Këshillit të Ministrave, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës të hyjë në fuqi.

12. Pas pezullimit të çështjes, gjatë shqyrtimit në themel të saj, Gjykata konstatoi se Këshilli i Ministrave, në datën 1.10.2014, ka miratuar vendimin nr. 642 (më poshtë “VKM nr. 642/2014”) me anë të të cilit ka shfuqizuar VKM nr. 354/2014 “Për ngritjen e bazës së të dhënave IMEI për regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme”, objekt shqyrtimi.

13. VKM-ja nr. 642/2014 e lartpërmendur, që parashikon se hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 8.10.2014. Pra, ka hyrë në fuqi në datën 8.10.2014. Kjo rrethanë u parashtrua edhe nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave.

14. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret ndodhet në kushtet kur VKM-ja nr. 354/2014, objekt shqyrtimi, i ka përfunduar efektet e saj. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se çështja mbetet pa objekt dhe se gjykimi i saj duhet të pushohet.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “c”, dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 4.6.2014 “Për ngritjen e bazës së të dhënave

IMEI për regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Gani Dizdari

#### MENDIM PAKICE

1. Në çështjen e kontrollit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 4.6.2014 “Për ngritjen e bazës së të dhënave IMEI për regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme”, shumica ka vendosur pushimin e gjykimit me arsyetimin se me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 1.10.2014, me anë të të cilit është shfuqizuar VKM-ja nr. 354/2014, objekt shqyrtimi, kjo e fundit i ka përfunduar efektet e saj dhe se çështja ka mbetur pa objekt (*shih paragrafët 12-14 të vendimit*).

2. Mjetin e përdorur nga shumica, pushimin e gjykimit, në gjyqtarët në pakicë, e gjejmë të sforcuar dhe mendojmë se nuk është i përshtatshëm për çështje të kësaj natyre për arsyet si më poshtë.

3. Nga rrethanat e çështjes rezulton se VKM-ja nr. 354/2014, sikurse konstaton edhe shumica (*shih paragrafin 2 të vendimit*), ka si qëllim detyrimin e regjistrimit të aparateve celulare nëpërmjet numrit IMEI, që përdoret në rrjetet që ofrojnë shërbime të lëvizshme; ofrimin e shërbimit vetëm me aparate me numra IMEI të regjistruar; ngritjen e bazës së të dhënave për numrat IMEI pranë Ministrisë së Financave; përcaktimin e organeve të cilave u jepet e drejta e aksesit në bazën e të dhënave.

4. Në këto kushte, kërkuesi ka pretenduar se VKM-ja, objekt kundërshtimi, cenon parimin e shtetit të së drejtës dhe, konkretisht: parimin e hierarkisë së akteve normative dhe kriteret kushtetuese për nxjerrjen e akteve nënligjore (nenet 4/1, 116 dhe 118 të Kushtetutës), si dhe



disa nga të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese, si, për shembull, të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, të sanksionuar nga neni 35 i Kushtetutës dhe neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe të fshehtësisë së komunikimit (neni 36 i Kushtetutës). Gjithashtu, kërkuesi parashtron se nëse për arsye të mbrojtjes së interesit publik apo të të drejtave të të tjerëve, është i nevojshëm kufizimi i këtyre të drejtave, ai mund të vendoset vetëm me ligj. Fakti që në rastin konkret ky kufizim është parashkuar me vendim të Këshillit të Ministrave, përbën tejkalim të kriterëve të përcaktuara në nenin 17 të Kushtetutës.

5. Mbrojtja dhe respektimi i parimeve të lartpërmendura kanë gjetur një trajtim të gjerë në jurisprudencën e kësaj Gjykate (*shih vendimet nr. 16, datë 11.11.2004 dhe nr. 52, datë 1.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe në atë ndërkombëtare (*shih vendimin e GJED-së, datë 8.4.2014, lidhur me çështjet C-293/12 dhe C-594/12, të cilat kanë të bëjnë me direktivën e BE-së 2006/24/EC të datës 15.3.2006 “Për mbajtjen e të dhënave të krijuara ose të përpunuara lidhur me shërbimet e komunikimeve elektronike të ofruara për publikun apo të rrjeteve të komunikimit publik”*).

6. Dyshimet serioze për cenimin e këtyre parimeve nga VKM-ja e lartpërmendur, e detyruan Mbledhjen e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të pranojë, njëzëri, kërkesën për pezullimin e aktit të kundërshtuar si të papajtueshëm me Kushtetutën, me qëllim parandalimin e pasojave që mund t’u vinin të drejtave dhe lirive themelore të individëve, si dhe funksionimit normal të shtetit të së drejtës.

7. Gjithashtu, Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të saj është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, fuqinë detyruese të arsyetimit të tyre. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*Shih vendimet nr. 5 datë 7.2.2001 dhe nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Nisur nga fuqia detyruese e vendimeve të

kësaj Gjykate, si dhe nga rëndësia e veçantë që merr kontrolli i pajtueshmërisë me Kushtetutën i ligjeve apo i akteve të tjera normative, me qëllim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, jemi të mendimit se marrja në shqyrtim e kushtetutshmërisë së VKM-së nr. 354/2014, edhe pse nuk do të kishte efekte të drejtpërdrejta në rastin konkret, në këndvështrim të standardeve kushtetuese, paraqet interes si në rregullimin e disiplinës ligjore objekt shqyrtimi për të ardhmen, ashtu edhe në konsolidimin e mëtejshëm të jurisprudencës së kësaj Gjykate në këtë aspekt. Për më tepër, në çështjen objekt shqyrtimi, ajo paraqet rëndësi në funksion të mbrojtjes së interesit publik, duke konsideruar parime të tilla si ai i shtetit të së drejtës, por edhe ndjeshmërinë dhe sidomos pritshmëritë e qytetarëve për garantimin e jetës private, të cilat kërkuesi pretendon se janë cenuar.

9. Së fundmi, vlerësojmë se përcaktimi, rast pas rasti, i parimeve kushtetuese në fusha të rëndësishme në drejtëm të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit (si ajo e mbrojtjes së jetës private), i shërbejnë stabilitetit juridik të vendit si një kusht i rëndësishëm për funksionimin e shtetit të së drejtës, në mënyrë që të evitohen ndryshimet e shpeshta në legjislacion, të cilat mund të çojnë në cenim të parimit të sigurisë juridike. Sikurse kjo Gjykatë ka theksuar, siguria juridike parakupton, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmërive të ligjshme. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim, kërkohet që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të (*shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në këtë këndvështrim, në ndryshim nga shumica, në rastin konkret, jemi të mendimit se Gjykata duhet të analizonte në themel dhe t’u



jepte përgjigje pretendimeve të palëve pjesëmarrëse në gjykim vetëm në lidhje me kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të aktit të kundërshtuar.

Anëtarë: Vladimir Kristo, Gani Dizdari

### VENDIM

Nr. 58, datë 5.12.2014

## NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina (Çinari) Basha, në datën 8.10.2013, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 35/8 Akti, që i përket:

KËRKUES: Agim Bega

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agim Arapi, Leonora Komini, Albana Komini, Sokol Komini, Edmond Komini

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2011-863 (241), datë 12.5.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

### GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjo i relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuësit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, pretendimet e subjektit të interesuar Agim Arapi, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

### I

1. Subjekti i interesuar Agim Arapi i është drejtuar Gjykatës Italiane me padi me objekt shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga një aksident në punë. Për ndjekjen e procedurave në shtetin italian ka caktuar si përfaqësues të tij një avokat italian. Pasi është kthyer në Shqipëri subjekti i interesuar, nëpërmjet prokurës nr. 688 rep, nr. 221 kol, datë 19.4.2003 ka caktuar si përfaqësues avokatin, kërkuësin, Agim Bega dhe subjektin e interesuar Llaqi Komini. Subjekti i interesuar Llaqi Komini ka vdekur dhe në Gjykatën e Lartë është bërë kalimi procedural tek trashëgimtarët e tij: Leonora, Albana, Sokol dhe Edmond Komini.

2. Përfaqësuesit e subjektit të interesuar Agim Arapi kanë pasur për detyrë të bashkëpunojnë me një avokat italian për zgjidhjen e çështjes së dëmshpërblimit deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Me deklaratën noteriale nr. 2257 rep, datë 31.12.2004, subjekti i interesuar ka shprehur vullnetin për t’iu dhënë përfaqësuesve shumën prej 35% të vlerës totale të dëmshpërblimit, që do të përfitonte pas vendimit të gjykatës italiane.

3. Në përfundim të gjykimit në shtetin italian, subjekti i interesuar Agim Arapi ka përfituar dëmshpërblimin në shumën 233.377 euro. Në zbatim të deklaratës noteriale me nr. 2257 rep, datë 31.12.2004, përfaqësuesit e tij kanë kërkuar të marrin të gjithë shumën e premtuar nga subjekti i interesuar, por kanë marrë vetëm shumën prej 30.000 euro. Si rrjedhojë kanë paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier me objekt kërkimin e shumës së papaguar prej subjektit të interesuar Agim Arapi.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 1027, datë 27.6.2006, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuësve Agim Bega dhe Llaqi Komini.

5. Mbi ankimin e kërkuësit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 125, datë 7.3.2007, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 1027, datë 27.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, pranimin e padisë, duke e detyruar subjektin e interesuar të paguajë shumën prej 51.682 euro dhe shumën prej 7.000 euro, si shpenzime të kryera në favor të subjektit të interesuar”.

6. Mbi rekursin e subjektit të interesuar, Agim Arapi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me





vendimin nr. 00-2011-863 (241), datë 12.5.2011, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 125, datë 7.3.2007 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1027, datë 27.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

## II

7. **Kërkuesi Agim Bega** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2011-863 (241), datë 12.5.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke argumentuar:

7.1 Me vendimin nr. 00-2011-863 (241), datë 12.5.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është shkelur parimi i sigurisë juridike, pasi janë cenuar të drejta të fituara ligjrisht. Arsyetimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë bie ndesh me ligjin nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” lidhur me tarifën e shërbimit të avokatisë.

7.2 Gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Sipas kërkuesit tre nga gjyqtarët që kanë marrë pjesë në dhomën e këshillimit, në të cilin është vendosur kalimi i çështjes për gjykim, kanë qenë në trupin gjykues të seancës gjyqësore. Një anëtare e trupit gjykues, e cila është shprehur kundër kalimit të çështjes për gjykim, pa ndonjë arsye, është zëvendësuar me një gjyqtar tjetër.

8. **Subjekti i interesuar, Agim Arapi**, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar:

8.1 Gjatë procesit në Gjykatën e Lartë është respektuar parimi i procesit të rregullt ligjor. Në kuptim të nenit 11 të ligjit nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit” deklarata noteriale e lëshuar nuk përbën një marrëveshje. Kërkuesi Agim Bega dhe avokati tjetër Llaqi Komini, pavarësisht se nuk kanë kryer shërbim në favor të çështjes, kanë marrë një shpërblim prej 30.000 euro.

9. **Subjektet e tjera të interesuara, trashëgimtarët e Llaqi Kominit** nuk kanë paraqitur parashtrime lidhur me çështjen.

## III

### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

10. Në analizën e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) paraprakisht thekson se i vlerëson pretendimet në drejtim të

standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimit të Gjykatës së Lartë për respektimin e këtyre standardeve.

#### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Gjykata Kushtetuese vlerëson të analizojë fillimisht legjitimitimin e kërkuesit në paraqitjen e kësaj kërkesë. Në nenet 131, shkronja “f”; 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës përcaktohet e drejta e individit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Gjykata Kushtetuese konstaton se në rastin konkret kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenin 134, shkronja “g”, *ratione materiae*, pasi kërkesa hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të përcaktuar në nenin 30 të ligjit nr. ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

12. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet për t’iu drejtuar kësaj Gjykate.

#### B. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

13. Kërkuesi ka pretenduar se qëndrimi i mbajtur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi janë cenuar të drejta të fituara ligjrisht. Kërkuesi ka pretenduar se arsyetimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar dispozitat e ligjit nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” lidhur me tarifën e shërbimit të avokatisë, me ose pa marrëveshje midis palëve, klient-avokat. Në rastin konkret, kërkuesi ka pretenduar se marrëveshja me subjektin e interesuar lidhur me tarifën e shërbimit nuk është cenuar për pavlefshmëri, për rrjedhojë gjykatat nuk kanë pasur të drejtë ta ndryshojnë ose të mos e marrin në konsideratë.

14. Gjykata ka theksuar se parimi i sigurisë juridike përfshin krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të



shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. (*shih vendimin nr. 4, datë 5.2.2014; nr. 10.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*)

15. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë dhe logjik. Një arsyetim i saktë i vendimit është një mënyrë e sigurt që gjeneron legjitimitet në sytë e të interesuarve. Ky efekt do të jetë akoma më i madh nëse palët do ta përjetojnë këtë vendim si pasojë normale e një procesi të rregullt në të gjithë komponentët e tij. (*shih vendimet nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 20, datë 13.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Nga ana tjetër, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është përmbledhje e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to. Vendimi që përmban ose lejon kontradiktën logjike, cenon rëndë dhënien e drejtësisë. Ai nuk mund të jetë i kuptueshëm dhe bindës dhe për pasojë nuk mund të zbatohet në praktikë. Një vendim i plotë dhe i kuptueshëm pasohet logjikisht edhe me vetë forcimin e sistemit gjyqësor. Ai kontribuon në shprehjen dhe thellimin e vlerave shoqërore që transmetohen përmes normave ligjore (*shih vendimin nr. 33, datë 8.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese vlerëson se çdo vendim gjyqësor që marrin gjykatat e zakonshme, duke mos zbatuar parimin

e procesit të rregullt ligjor lidhur me detyrimin për t'i arsyetuar ato, ka efekte negative për palët që kanë kërkuar drejtësi nga këto gjykata.

18. Bazuar në rrethanat e çështjes konkrete, rezulton se midis palëve në gjykim ka pasur një komunikim të ndërsjelltë, kërkesë për ndihmë juridike, si dhe asistim faktik të kërkuarit ndaj subjektit të interesuar. Gjykata e Lartë, në zbatim të ligjit procedural, ka bërë një vlerësim të faktit dhe provave të rezultuara, duke pranuar se ka një marrëveshje mes kërkuarit dhe subjektit të interesuar për pagesën e shërbimit të ofruar dhe të kryer. Por, për tarifën në përqindje (35% e shumës që do të fitonte subjekti i interesuar si dëmshpërblim) caktuar në këtë marrëveshje është vlerësuar se nuk është respektuar parimi i proporcionalitetit mes vlerës së tarifës dhe synimit të arritur në favor të klientit, i cili ka përfituar shumën prej 233.377 euro, si pasojë e dëmtimeve të përhershme që ka pësuar.

19. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se parimi i proporcionalitetit nuk përbën ndërhyrje në lirinë e vlerësimit të shërbimit të ofruar, por vendos palët në atë gjendje që askush të mos detyrohet të përballojë një barrë të tepërt.

20. Në nenin 1 të ligjit nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “*Avokatia në Republikën e Shqipërisë është profesion i lirë, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar*”. Si një ligj që rregullon një fushë të veçantë ai ka përcaktuar përmbajtjen dhe kufijtë e të drejtës së ushtrimit të këtij profesioni. Një nga të drejtat e njohura prej ligjit është e drejta e shpërblimit (nenet 11 dhe 12 të tij). Në ligj janë parashikuar disa mënyra për shpërblimin e avokatit. Në nenin 12/2 përcaktohet se: “*Shpërblimi me përqindje, i paralogaritur ose jo, mund të paguhet vetëm kur është parashikuar në marrëveshjen ndërmjet avokatit dhe personit që ai mbron ose përfaqëson, për rastin e mbrojtjes apo përfaqësimit të suksesshëm të çështjes*”.

21. Gjykata thekson se është kompetencë e Gjykatës së Lartë të vlerësojë respektimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta. Në rastin në shqyrtim rezulton se Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka arsyetuar se deklarata noteriale e lëshuar nga subjekti i interesuar i ka elementet për t'u konsideruar si “marrëveshje mes palëve”, duke konfirmuar pritshmëritë legjitime të kërkuarit. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se



kjo marrëveshje nuk mund të përfshijë tarifa të caktuara me përqindje në përpjesëtim me vlerën e çështjes që trajtohet, nëse kjo nuk është në përputhje me një përshkallëzim të tarifave të miratuara zyrtarisht ose sipas kontrollit të autoritetit kompetent që ka juridiksionin mbi avokatin. Tarifa, sipas Gjykatës së Lartë, duhet të jetë plotësisht e qartë, e drejtë dhe e arsyeshme. Gjykata e Lartë ka analizuar faktet e paraqitura gjatë procesit gjyqësor, ka bërë një referim në ligjin përkatës dhe në përfundim ka vendosur prishjen e vendimit nr. 125, datë 7.3.2007 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1027, datë 27.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

22. Gjykata Kushtetuese konstaton se në çështjen konkrete Gjykata e Lartë ka aplikuar parimin e proporcionalitetit, i cili njihet gjerësisht si një parim i aplikueshëm në të drejtën publike. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë shqyrtuar dhe analizuar rrethanat e çështjes, provat e paraqitura dhe kanë argumentuar në vendim qëndrimin e tyre lidhur me pretendimet e palëve ndërgjyqëse. Qëndrimi i mbajtur nga gjykatat më të ulëta lidhur me konceptin e tarifës ka qenë i ndryshëm. Gjykata e Lartë, nëpërmjet arsytimit të saj, ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e mbajtur prej gjykatës së shkallës së parë, por ka pranuar marrëveshjen e lidhur midis subjekteve, e cila ka fuqinë e ligjit për palët. Ndërhyrja e Gjykatës së Lartë në këtë marrëveshje, duke aplikuar parimin e proporcionalitetit, ka cenuar pritshmëritë e ligjshme të kërkuarit. Sipas ligjit nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” shpërblimi vendoset me marrëveshje, çka përjashton zbatimin e parimit të proporcionalitetit. Shpërblimi me përqindje në çështjen konkrete është vendosur me marrëveshje në respektim të nenit 12 të ligjit. Marrëveshja mes palëve presupozon zbatim të tarifës së shërbimit sipas kontratës. Në këto rrethana, Gjykata e Lartë duhet të arsyetonte në vendimin e saj në mënyrë të qartë, të saktë dhe të plotë konceptin e tarifës proporcionale të pranuar prej saj. Gjithashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të arsyetonte mosmarrjen parasysh të kontratës por edhe të ligjit në lidhje me tarifën e shërbimit. Mosarsyetimi i qartë dhe i kuptueshëm nga Gjykata e Lartë për mosmarrjen në konsideratë

të marrëveshjes ka cenuar një gjendje juridike të krijuar dhe të drejtat e fituara nga palët.

23. Gjykata Kushtetuese thekson se gjykatat duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe bindëse në arsytimin e vendimit. Gjykata e Lartë, në rastin konkret, për të realizuar përputhjen e interesave të palëve në mënyrë të paanshme, meqenëse ka marrëveshje lidhur me shpërblimin, duhet të arsyetonte se çfarë kuptohet me “tarifë proporcionale”, gjë që do të justifikonte mospranimin e tarifës së përcaktuar nga vetë palët me marrëveshjen mes tyre. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se respektimi i përmbushjes së kushteve të kufizimit të një të drejte kërkon një trajtim të diferencuar, në varësi të të drejtave dhe lirive individuale që i nënshtrohen kufizimit (*shih vendimin nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se argumentet e përdorura në arsytimin e vendimit nr. 00-2011-863 (241), datë 12.5.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë kanë cenuar parimin e sigurisë juridike.

*C. Për respektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*

25. Kërkuarësi ka pretenduar se tre nga gjyqtarët që kanë marrë pjesë në dhomën e këshillimit, ku është vendosur kalimi i çështjes për gjykim, kanë qenë në trupin gjykues të seancës gjyqësore. Një anëtare e trupit gjykues, e cila është shprehur kundër kalimit të çështjes për gjykim, pa ndonjë arsye, është zëvendësuar me një gjyqtar tjetër. Në këto kushte, kërkuarësi pretendon se vendimi i dhënë është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar.

26. Gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Gjykata ka theksuar, në jurisprudencën e saj, se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në



këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Dyshimi i mundshëm për paanshinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 12, datë 13.4.2007; nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Jurisprudenca e deritanishme e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar “*gjykatë e njëanshme*” kur në përbërjen e trupit gjykues ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili në këndvështrimin objektiv nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një ose më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i pranisë dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e çështjes (*shih vendimet nr. 48, datë 30.7.1999; nr. 1, datë 25.1.2010; nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata duke iu referuar jurisprudencës së saj thekson se, sikundër për pranimin ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj luan rolin e një filtri paraprak në vlerësimin e kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sigurisht, që palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh, prima facie, i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë publike, por kjo nuk mund ta deformojë funksionin vlerësues të dhomës së këshillimit.

Faqe | 10686

29. Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se pjesëmarrja e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në kolegjin seleksionues e më pas edhe në vendimmarrjen përfundimtare nuk përbën cenim të parimit të paanshisë gjatë gjykimit. Gjykata lidhur me pretendimin për mosmarrjen pjesë të gjyqtares, e cila ishte shprehur kundër kalimit të çështjes për shqyrtim gjatë seancave gjyqësore, vlerëson se është i pabazuar, pasi zëvendësimi i gjyqtares është bërë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 12.5.2011, rezultoi se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vënë në dijeni palët se në përbërjen e trupit gjykues nuk merr pjesë gjyqtarja M.A për shkaqe ligjore, e cila është plotësuar nga një gjyqtar tjetër sipas procedurave të shortit dhe sipas grafikut të çështjeve.

30. Në përfundim, Gjykata Kushtetuese konstaton se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë është cenuar parimi i sigurisë juridike, për rrjedhojë ky pretendim i kërkuesit është i bazuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2011-863 (241), datë 12.5.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha



## MENDIM PAKICE

1. Ne gjyqtarët në pakicë jemi kundër qëndrimit të shumicës në çështjen me kërkuar Agim Bega, ndaj ju paraqesim, në vijim, argumentet tona për këtë qëndrim.

2. Në kërkesën e tij, mes të tjerash, kërkuar ka pretenduar se vendimi nr. 00-2011-863 (241), datë 12.5.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, për arsye se janë cenuar të drejta të fituara ligjrisht, dhe se arsyetimi i Kolegjit Civil bie ndesh me ligjin nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” lidhur me tarifën e shërbimit të avokatisë.

3. Në përfundim të gjykimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se “Gjykata e Lartë duhet të arsyetonte në vendimin e saj në mënyrë të qartë, të saktë dhe të plotë konceptin e tarifës proporcionale të pranuar prej saj. Gjithashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të arsyetonte mosmarrjen parasysh të kontratës, por edhe të ligjit në lidhje me tarifën e shërbimit. Mosarsyetimi i qartë dhe i kuptueshëm nga Gjykata e Lartë për mosmarrjen në konsideratë të marrëveshjes, ka cenuar një gjendje juridike të krijuar dhe të drejtat e fituara nga palët... Gjykata e Lartë, në rastin konkret, për të realizuar përputhjen e interesave të palëve në mënyrë të paanshme, meqenëse ka marrëveshje lidhur me shpërblimin, duhet të arsyetonte se çfarë kuptohet me “tarifë proporcionale”, gjë që do të justifikonte mospranimin e tarifës së përcaktuar nga vetë palët me marrëveshjen mes tyre” (paragrafët 22-23 të vendimit). Bazuar në këto argumente, shumica ka vlerësuar se arsyetimi i vendimit nr. 00-2011-863 (241), datë 12.5.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike.

4. Në jurisprudencë të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme, por kontrolli që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Interpretimi i ligjit duke përcaktuar përmbajtjen e tij është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i

kuptimit apo interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor.

5. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë një rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata u kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të kërkuarit (*shih vendimin nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë, çka vjen si pasojë e pozicionit të saj si organi më i lartë i sistemit gjyqësor dhe lidhet me funksionin e përgjithshëm të saj për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t’u përmbahen (*shih vendimin nr. 6, datë 17.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në vendimin e saj shumica ka arsyetuar, fillimisht, se sipas ligjit për profesionin e avokatit shpërblimi vendoset me marrëveshje, çka përjashton zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe, më pas, se Gjykata e Lartë, për të realizuar përputhjen e interesave të palëve në mënyrë të paanshme, meqenëse ka marrëveshje lidhur me shpërblimin, duhet të arsyetonte se çfarë kuptohet me “tarifë proporcionale”, gjë që do të justifikonte mospranimin e tarifës së përcaktuar nga vetë palët me marrëveshjen mes tyre.

7. Ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se qëndrimi i Gjykatës së Lartë në rastin konkret lidhet me kompetencën dhe njëkohësisht detyrimin kushtetues e ligjor të saj për të përcaktuar dispozitën që duhet të zbatohet në çështjen konkrete në gjykim dhe për ta interpretuar atë në raport me provat e administruara në gjykatat e faktit. Në këtë kuptim, çështjet që janë bërë objekt vlerësimi në vendimin e shumicës nuk i përkasin juridiksionit kushtetues, por atij gjyqësor. Gjykata Kushtetuese nuk mund të dublojë këtë funksion të gjykatës të zakonshme e veçanërisht të



Gjykatës së Lartë, duke rivlerësuar interpretimin e së drejtës materiale të zbatueshme, por ajo duhet të përqendrohet në respektimin e garancive kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Një qëndrim i kundërt do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një gjykatë të shkallës së katërt të juridiksionit të zakonshëm.

8. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimet nr. 34 datë 3.10.2007; nr. 34, datë 25.7.2011; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim shumica nuk ka arritur të argumentojë se në ç`mënyrë standardi i arsytimit të vendimit ka cenuar parimin e sigurisë juridike. Bazuar në nenin 485/b të KPC-së, në përfundim të gjykimit të çështjes Gjykata e Lartë ka të drejtë të vendosë, mes të tjerash, edhe prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, çka do të thotë se edhe një situatë e favorshme e krijuar në favor të njëres palë mund të cenohet nga ky vendim, duke vendosur në favor të palës tjetër.

9. Për sa i përket parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si një domosdoshmëri dhe garanci për procesin e rregullt ligjor, Gjykata ka përcaktuar standardet që duhet të plotësojë një vendim në mënyrë që të konsiderohet i arsyetuar. Gjykata ka theksuar se vendimet gjyqësore duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Pra gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve (*shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka përmbushur mjaftueshëm këto standarde. Ky vendim nuk rezulton që të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër. Përfundimi në të cilin ka arritur Kolegji Civil në vendimin e tij është rezultat i analizës së ligjit të zbatueshëm në lidhje me faktet e çështjes konkrete në shqyrtim.

10. Për sa më sipër, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Agim Bega është e pabazuar dhe ajo duhej të ishte rrëzuar nga Gjykata.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Sokol Berberi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 40 lekë